



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 7 TETOR 2010**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
7. OKTOBRA 2010. GODINE**

**TETOR – OKTOBRA
2010**

E enjte, 7 tetor 2010, ora 10:00

Drejton seancën: anëtari i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të Qeverisë së Kosovës,

I hapi punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit, fillojmë me deklarinimet e deputetëve, përkatësisht të grupeve parlamentare për çështjet që janë në rend të ditës.

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi, sipas Rregullores, e dini, 5 minuta kryetarët e grupeve parlamentare, 3 minutat deputetët.

Nga mbledhja plenare e kaluar kanë mbetur pa diskutuar këta deputetë: Naim Rustemi, Lulzim Zeneli, Riza Smaka, Ismajl Kurteshi dhe Fatmir Rexhepi.

Fillojmë me diskutuesin e parë, deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Të nderuar, me Ligjin për deklarimin e pasurisë, neni 1.1, pika 9, kërkohet që udhëheqësit e agjencive, të drejtorive dhe të institucioneve tjera të nivelit qendror, të themeluar me ligj ose me ndonjë akt tjetër, të tregojnë për pasurinë e tyre. Çuditërisht, nga mediet dhe Shoqëria Civile kuptohet se Bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit nuk ka bërë deklarinim të pasurisë. Duke pasur parasysh se udhëheqësi i Agjencisë së Privatizimit është bartës i një prej privatizimeve më të mëdha në Kosovë, që është një privatizim i çuditshëm dhe është vështirë të gjendet ndonjë akt ligjor që ka lejuar një gjë të tillë. Këtë më së mirë mund ta dijë komuna e Prishtinës, që dha 11 hektarë tokë për ndërtimin e dy banesave kolektive. E rëndësishme është që nuk i ka plotësuar kushtet e garës dhe transparencës, por vetëm ata e dinë se e kanë dhënë këtë parcelë të tokës së Prishtinës. A thua a janë ende duke bërë pazare të tilla pa përfillë asnjë bazë ligjore? Si është e mundur që të mos deklarojnë pasurinë personat të cilët janë bartës të zhvillimit ekonomik dhe si proces i privatizimit gjithkund në botë është në fokus të luftës kundër korrupsionit. Ndoshta edhe po, e pse jo, pse ta deklarojnë pasurinë, janë të siguritë se s'ka kush çka iu bën, se janë të lidhur fort. Në mos të ishin të lidhur fort, atëherë si kishin pas mundësi ta marrin në shfrytëzim parcelën prej 11 hektarëve pa procedura paraprake, pa asnjë procedurë ligjore.

Investitor në projektin e Fshatit Ndërkombëtar, sipas WEB faqes zyrtare të projektit, është edhe komuna e Prishtinës dhe kush nuk e di pse duhet të hezitohet, pritohet të jepen të dhënat se kush janë pronarët e këtyre shtëpive. Sipas deklarimeve të zyrtarëve, së paku 100 shtëpive nuk u dihet pronari. Po themi nuk u dihet se kush i ka, po normal se ata dihen, por nuk thuhet. Mund të jenë ministra që blejnë shtëpi me vlerë 300 – 400 mijë euro, me rroga të tyre të varfra 1.200 euro. Këto nuk janë fjalë për “hava”, siç kish për t'i quajtur kryetari Jakup Krasniqi, por këto janë fjalë të “tokës e të bukës”, si kish për të thënë populli.

Dhe ja një prej fjalive që gjendet në WEB faqen e Fshatit Ndërkombëtar: “Lagje në një lokacion piktores ku luksi takohet me rahatën dhe ku fqinjët bëhen shokë të përjetshëm”.

Dhe unë po ju them juve, të nderuar, se nuk ka nevojë të bëhen shokë para se të vinë ata, mund të jenë shokë para se ta blejnë apo t'u falen shtëpitë në këtë lagje. Ndoshta ekzekutivi i këtij projekti të privatizimit është në lidhje të drejtpërdrejtë me blerësit, të cilët nuk kanë dëshirë që t'u shpalosen të

dhënat. Ata mund të jenë ministra, kryeministra, zëvendësit e tyre apo shokë, por edhe mund t'i kenë transferuar në emër të truprojave, raste për të cilat askush nuk mund ta futë në mendje se si është e mundur që një person me pagesë 200 -300 euro të ndërtojë banesa shumëkatëshe. Këtë e dinë veç ata që mund të marrin para nga bizneset, prokurimet, tatimet, ndoshta edhe nga sigurimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shqetësimet tona, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kanë të bëjnë dhe janë shqetësime në vazhdimësi për mosfunksionimin e shtyllave kryesore të shtetësisë dhe, si rrjedhojë, kjo determinon edhe mosfunksionimin e shtetit kushtetues.

Rasti i zoti Sejdiu, si ish kryetar i vendit, ishte vetëm maja e Ajzbergut, e shkeljeve të rënda kushtetuese që po ndodhin në vazhdimësi nga mentaliteti dhe veprimi antikushtetuese të pushtetit aktual.

Zoti kryetar i Kuvendit, po ju drejtohem në cilësinë e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Kosovës, të reflektoni mbi interesat partiake, si garantues i funksionimit të institucioneve kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se politikat e veprimeve antikushtetuese të pushtetit aktual kanë krijuar varg zinxhior të shkeljeve të rënda antikushtetuese. LDD mbetet e shqetësuar se përkundër faktit që nga 15 nëntori 2009 e gjer tani institucionet e Republikës së Kosovës, niveli qendror vazhdon të rrijë indiferent karshi situatës antikushtetuese dhe antiligjore të krijuar në komunën e Prizrenit. Fakti se një situatë e tillë është e papranueshme edhe për qytetarët e komunës së Prizrenit, kanë treguar letrat e drejtuara në vazhdimësi në drejtim të institucioneve qendrore. Kur kësaj ia shtojmë edhe gjendjen e krijuar në komunën e Rahovecit, atëherë situata është tejet e komplikuar dhe tejet serioze.

Zoti kryetar,

Ne kërkojmë që të ushtroni ndikimin tuaj me kapacitetin e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Kosovës, që të hapni mundësi për zhbllokimin e funksionimit të pushtetit lokal në komunën e Prizrenit dhe në komunën e Rahovecit. Përndryshe, Kosova do të karantinohet me këtë politikë antikushtetuese dhe proceset integruuese, që janë synim i qytetarëve dhe i shtetit të Kosovës, do të jenë shumë të largëta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Zotëri zëvendëskryeministër, ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Edhe në emër të grupit. Në vendin tonë ekziston një institucion që quhet Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme për çështjet e Agjencionit për Mirëbesim. Emërtimi është i gabueshëm, se "Dhomë" do të duhej të ishte "Kolegj" a do të duhej të ishte organizativisht në kuadrin e Gjykatës Supreme, që nuk është, dhe do të duhej t'i përgjigjej funksionalisht, që nuk i përgjigjet, një.

Dy, kjo dhomë është krejtësisht indolente dhe indiferente se i përket vendosjes së rasteve juridike. Rastet juridike i zhagitë deri në 6 vjet, që është shumë më inefikase se gjykatat tona, të cilat i kritikojmë ditë e natë, ju lutem! Gjykatësit e kësaj gjykate janë ndoshta 10 herë më mirë të paguar se gjykatësit tanë, domethënë nuk është fjala te pagesa.

Ajo që është më dhe më brengosëse, është kjo. Kjo gjykatë, gjykatë në të vërtetë, kjo dhomë, kjo dhomë, ju lutem, e zbaton një akt nënligjor terciar, një udhëzim administrativ i cili është antikushtetutar, është në kolizion me parimet juridike ndërkombëtare valide sa i përket gjuhësisë, direkt është në kolizion me nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës sa i përket gjuhësisë, sepse nuk ua pranon për procedim palëve lëndët në qoftë se të gjitha shkresat, e ato shpeshherë janë voluminoze kaq, në qoftë se nuk janë përkthyer në anglisht dhe, më në fund, ato i hudhë adacta, quo vadis, nonsense. Ja udhëzimi juridik që është premtor, ja çka thotë ndër të tjera: All previous and supporting documents submitted must be only in English. Documents not submitted in English or accompanied by English translation will not be accepted. Kështu ka vepruar edhe në shumë raste. E marr vetëm një shembull ekzemplar. Organizata biznesore Marketingu, 6 vjet lëndën e ka aty, është një lëndë vëllimore që pretendon për 4 katet e objektit të OSBE-së dhe nuk ia ka vendosur nën kanosje që duhet t'i përkthejnë. Këta të papunë qe 10 vjet, qira s'kanë marrë fare, dhe çka ka ndodhur? Lëndën e ka hudhur adacta. Kjo është një nonsens, kjo nuk mund të ndodhë askund, vetëm në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje, për Kabinetin qeveritar dhe për deputetët!
Zoti kryesues,

Këto ditë në Kosovë ka filluar procesi i privatizimit të 12 stacioneve të autobusëve. Të gjitha komunat ku po ju privatizohen stacionet, kanë reaguar, sepse ato konsiderojnë që këto stacione janë shumë të nevojshme për shërbimin e qytetarëve dhe për komuna. Më tutje, në një vendim të kryeministrit Çeku, nr. 03/273 të datës 26 shtator të viti 2007, në pikën 1 thuhet: "Pronat e stacioneve të autobusëve të barten në menaxhim të gjitha komunave të Kosovës". Ky vendim është mbështetur në ligjet në fuqi, edhe sot është në fuqi, askush nuk e ka shfuqizuar. Prandaj, kërkoj që edhe në emër të qytetarëve dhe të komunarëve të Gjilanit që procesi i privatizimit të stacioneve të autobusëve të ndërpritet menjëherë dhe të veprohet sipas vendimit i cili edhe sot është në fuqi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Fatmir Rexhepi. Regjia, deputetit Fatmir Rexhepi fjalën!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryesues!
Përshëndetje, kolegë deputetë, Kabinet qeveritar!
Mora fjalën te deklarimi i lirë për të thënë diçka lidhur me vlerësimin politik timin nga ngjarjet e fundit, gjegjësisht zhvillimet politike që ndodhën nga një vendim, interpretim juridik i Kushtetueses, por gjithsesi me një interferim, gjegjësisht impakt të madh në jetën politike institucionale, që unë do ta quaja, pra, një ndërhyrje në rendin kushtetuese institucional dhe politik të vendit.

Institucionet e tilla mendoj që duhet të kenë parasysh cilindo interpretim që e bëjnë për impaktin që ka në rrjedhën apo pasojat e një vendi dhe kjo lë shumë për të dëshiruar në momentin e caktuar për

të gjithë njerëzit, për të gjithë ata që mendojnë drejt dhe njihen në jetën tonë politike, ta vlerësojnë objektivisht dhe realisht.

Prandaj, në kuadër të kësaj, unë personalisht mendoj që në ditën e largimit të presidentit nga detyra, duke respektuar vendimin në fjalë, është zhvlerësuar totalisht marrëveshja politike e ekzistimit të koalicionit të PDK-së dhe LDK-së në qeverisjen e vendit. Pra, që nga ajo ditë, unë personalisht e vlerësoj se është jashtë funksionit dhe është nul apo është një marrëveshje e vdekur, andaj është shumë mirë që këto dy parti të mendojnë që ta bëjnë publike këtë. Në kuadër të kësaj, unë e ftoj Lidhjen Demokratike të Kosovës, Eqremi s'qenka këtu, që sa më shpejt, pra, në takimet e saj si parti të veprojnë në pajtim me rregullat dhe normat edhe kur krijohet ose ndërtohet një marrëveshje politike, që t'i japë fund këtij koalicioni dhe mendoj që kjo do të ishte puna më e ndershme politike, që vendi jonë të shkojë drejt një qeverie teknike, e cila do të përgatit zgjedhjet, zgjedhje të cilat duhet të mbahen, me fillimin e pranverës, në mënyrë që realisht të kemi një hapësirë, një ambient shumë më të mirë politik për të mbajtur zgjedhje ashtu qysh i duhen vendit. Këtë mision i takon ta marrë LDK-ja dhe aspak ta luaj rolin i cili nuk i takon në këtë koalicion. Këtë e them për arsye që nuk mundet Kryesia e Partisë dhe LDK-ja të luaj rolin "mirë me nënën, mirë me njerkën". Nuk mundet, pra. Ose duhet të punojë për demokracinë dhe shtetin ligjor, ose të njëjtën kohë nuk mundet, pra, për një qeveri të koalicionit, të cilës i ka dal mandati me ditën që është larguar presidenti, është shkelë marrëveshja, pra kemi një veprim kundër shtetit ligjor.

Prandaj, e ftoj edhe një herë kryetarin e vendit, zotin Jakup Krasniqi, që të marrë të gjitha hapat e mundshëm politikë gjatë tetorit për krijimin e një qeverie teknike, e cila për mua është i vetmi garant që mundëson zgjedhje të ndershme dhe të mira. I kemi zgjedhjet komunale nga e kaluara dhe nëse nga kjo nuk kemi mbledh mend dhe të shohim se çfarë masakre i është bërë demokracisë, unë nuk e di se...

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhepi!

Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është jashtëzakonisht i shqetësuar rreth rastit të largimit apo të mbetjes pa punë të një numri shumë të madh të punëtorëve të fabrikës "Llamkos" në Vushtri, fabrikë e cila është privatizuar në qeverinë e kaluar, është privatizuar nga Agjencia apo nga AKM-ja e kaluar, gjë të cilën e kemi trashëguar, mirëpo këta njerëz të cilët kanë mbetur pa punë, të cilët janë mbi 500 familje, do të duhej të dalin nga kjo situatë. Meqë AKP-ja është në kompetencë dhe i raporton Kuvendit të Kosovës, ne kërkojmë që komisionet parlamentare gjegjëse, por edhe Kuvendi në përgjithësi të caktojë një seancë plenare, të diskutojë haptas për problemin që ka ndodhur, t'i marrë të gjitha të dhëna se si është privatizuar kjo fabrikë, e cila i ka lënë pa punë mbi 500 punëtorë dhe të diskutojë edhe rreth çështjes pse po dështon procesi i privatizimit edhe dy herë radhazi, sepse në këtë kompani janë akumuluar borxhe të mëdha diku mbi 10 milionë. Ne e falënderojmë Qeverinë që dje i ka prit disa nga përfaqësuesit e punëtorëve apo ish punëtorëve të "Llamkosit", po natyrisht kërkojmë si Grup Parlamentar që të jetë përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës dhe të marrim obligim, edhe pse nuk ka lindur ky problem gjatë mandatit të këtij Kuvendi dhe të kësaj Qeverie, po të marrim obligim që ta zgjedhim këtë detyrë apo këtë problematikë për t'i shpëtuar njerëzit nga kjo katastrofë në të cilën janë futur.

Dhe, një çështje tjetër që dëshirojmë ta ngrehim, është çështja e deklarimit të pasurisë, duke fillua nga kreu i Agjencisë Antikorrupsion dhe drejtorëve të departamenteve, që është pa fajin e tyre, ata e kanë deklaruar pasurinë, i kanë formularët, por Kuvendi i Kosovës, unë e kam diskutuar edhe një herë paraprakisht, por edhe një herë po e them, duhet që administrata t'i bëjë propozim Kuvendit, Kryesia e Kuvendit ta autorizojë njërin nga komisionet parlamentare që të pranojë raportet e Agjencisë kundër Korrupsionit, sepse me ligjin e ri është paraparë që të formohet një komision parlamentar. Meqë Kuvendi i Kosovës nuk ka nevojë për komisione parlamentare, sepse ka edhe shumë, është të autorizohet njëri nga komisionet parlamentare, deri tash ka qenë Komisioni për Legjislacion, që t'i pranojë këta formularë apo të nxjerrë autorizim që këta formularë të bëhen publik dhe ta mbyllin edhe këtë kapitull për deklarimin e pasurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Blerim Ramosaj.

BLERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përhëndetje për Kabinetin qeveritar!

Deputetë të nderuar,

Veprimet e fundit të EULEX-it, të KFOR-it dhe të Policisë së Kosovës në veriun e Mitrovicës e qet në pah nevojën e ndryshimit të gjendjes së status kuos 10 vjeçare në këtë pjesë të Kosovës.

Kosova tani, pas shpalljes së pavarësisë, pas një opinionit shumë të rëndësishëm të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pas Rezolutës së aprovuar në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, na obligon që të jemi më agjil në pjesëmarrjen tonë në të gjitha veprimet, si institucione të Kosovës, në veprime që çojnë kah integrimi i kësaj pjese të Kosovës. Mendoj që Kuvendi i Kosovës duhet të japë mbështetje në një seancë apo në seancën e sotme, t'u japë mbështetje të gjitha këtyre veprimeve të fundit, të cilat vërtet çojnë në një gjendje shumë më të favorshme dhe në dialogun e mundshëm për çështje praktike me palën serbe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përhëndetje, zotërinj ministra, kolegë deputetë!

Po bëhet fjalë gjithashtu për punëtorët që kanë mbetur pa punë të Fabrikës së Lllamarinës zinkuar në Vushtri. Ata dje i kanë shprehur shqetësimet e veta përmes protestës para Qeverisë dhe Qeveria e pati rastin edhe një herë t'ju tregojë se nuk është në kompetencë të vet, por është në kompetencë të Kuvendit të Kosovës Agjencioni Kosovar i Privatizimit. Greva është ndërprerë për një javë, por i bashkëngjitem plotësisht kërkesës së deputetit të mëhershëm që diskutoi për këtë temë, që jo vetëm duhet të bëhet debat për punën e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, Privatizimit tash, e njëjta gjë është, por gjithashtu duhet me fokus të veçantë të diskutohet për çështjen e kësaj fabrike, si dhe të ngrihet një grup hetimor parlamentar për ta parë çka është gjendja në përgjithësi në këtë agjencion, në veçanti rreth punës në këtë fabrikë. Ka atje aq parregullsi të mëdha sa që kanë marrë në emër të fabrikës edhe kredi të pasqaruara të cilat duhet të sqarohen në të ardhmen me siguri, pse ende jo vetëm që nuk janë larë, por tash ka hipur kamata 700 – 800 mijë euro, duhet të vërtetohet, kështu që është shumë e nevojshme të bëhet kjo dhe mendoj në seancat e ardhshme kjo duhet të ndodhë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Mendoj që në Kosovë nuk janë veç punëtorët e Fabrikës së Lllamarinës, por janë më shumë se 200 mijë punëtorë që janë të papunë në procesin e privatizimit dhe me qenë se Fabrika e Lllamarinës ose të interesuarit për Fabrikën e Lllamarinës kanë lobuar, është mirë që të zgjidhet si problem, por unë pa e marrë rolin e avokatit të askujt, ne kemi miratuar Ligjin për privatizimin, kemi miratuar privatizimin në Kosovë dhe në qoftë se Parlamentit i intereson ose Qeverisë që ta ndërpresë privatizimin, është një çështje tjetër.

Sipas radhës, deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Do të doja që sot ta shfrytëzoj rastin që gjeneralit Iv de Kermabon, udhëheqësit të deritashëm të EULEX-it, me rastin e largimit nga Kosova, t'i uroj shëndet, fat dhe suksese në jetë dhe për kohën (pra për rreth tri vjet) që qëndroi në Kosovë si udhëheqës i EULEX-it, t'i falënderohem për asgjë!

General Kermabon, Mersi pour rien! General de Kermabon, Thank you for nothing!

Gjeneral de Kermabon, udhëheqës i EULEX-it në Kosovë që nga shkurti i vitit 2008, faleminderit për asgjë - sepse nuk bëre asgjë. Pos asaj që në fillim na tregove disa përralla se si “kriminelët duhet t'i frikësohen EULEX-it.”, dhe se “askush nuk do të jetë mbi ligjin”, sikurse bashkë me nëpunësin tuaj (kryeprokurorin), zotin Theo Jacobs na premtuat “se ‘peshqit e mëdhenj’ janë duke u hetuar dhe së shpejti do të shihen rezultatet”, duke e paralajmëruar janarin e 2009, si afatin më të largët, por në realitet deri në fund u morët vetëm me disa gilica - “peshq shumë të vegjël”.

Premtime të ngjashme dhatë edhe më pastaj me bashkëpunëtorin tuaj tjetër, z Johannes van Vresweejk, me të cilin na premtuat “verë të nxehtë”, për të na zhgënjyer përsëri sepse na dhatë “një verë shumë të ftohtë”.

Ju, i nderuari gjeneral Kermabon, para dy jave si arsyetim për atë që nuk bëtë asgjë që nga shkurti i vitit 2008, dhatë një arsyetim shumë nënçmues për të gjitha institucionet e Unionit European. Ju, i nderuari gjeneral, thatë se “gjërat nuk mund të arrihen brenda natës, por duhet punë”.

Po e them degradues, sepse EULEX arriti në Kosovë se bashku me pavarësinë, d.m.th. së bashku me përgjegjësinë që e morën “peshqit e mëdhenj” të Kosovës, e morët edhe ju, kurse deri atëherë fushën e ekonomisë (ku dyshohet të jetë korrupsioni – apo hajnia më e madhe dhe kryesore, për çka ju i nderuar gjeneral u paguat me rrogë të majme për rreth tri vite për ta luftuar pikërisht këtë hajni) e udhëhoqi Misioni i Unionit European në Kosovë, i njohur si EUMIK. A thua kolegët tuaj nga UE për rreth 8 vite kishin keqmenaxhuar, për të mos thënë se kishin vjedhur aq shumë, sa që ju atë hajni nuk mundët ta zgjidhni për rreth tri vite, sepse zoti gjeneral në Kosovë tjetërkush nuk ka mundur të vjedhë, ose stafi i Unionit European në Kosovë, ose stafi vendor. Apo thënë në vokabularin e kryeprokurorit Jakobs ose “peshqit e mëdhenj” të Brukselit, ose “peshqit e mëdhenj” të Kosovës. Gjeneral Kermabon, t'ua rikujtoj se vetëm për 16 muajt e parë ju i patët në dispozicion rreth 205 milion euro dhe rreth 3.000 të punësuar (nga të cilët rreth 1.900 nga UE dhe 1.100 vendor). Resurse të ngjashme patët edhe më pastaj, dhe çka arritët me gjithë ato resurse? Asgjë, më keq se hiq!

Të nderuar qytetarë, do ta shfrytëzoj rastin që t'i uroj mirëseardhje gjeneralit Ksavier de Marnhac, me shpresë se ai me të vërtetë do ta arsyetojë rrogën për të cilën do të paguhet.

Pra, të merret në praktikë me kriminelët, sidomos me “peshqit e mëdhenj” kushdo qofshin ata, sepse siç pati deklaruar gjeneral Kermabon “askush nuk duhet të jetë mbi ligjin dhe se misioni i

EULEX-it është i karakterit teknik dhe ai duhet të evitojë çdo ndikim politik, medial, financiar apo tjetër fare“, e jo të merret vetëm me deklarata për “peshqit e mëdhenj”, e pastaj kah fundi i mandatit të na tregojë sesi “rezultatet nuk mund të arrihen brenda natës, por duhet punë”. Prandaj le t’ia fillojë punës menjëherë gjeneral De Marnhac, se kosovarët janë ngi me llafe. Është shumë e vërtetë se ne kosovarët jemi mikpritës dhe e kuptojmë faktin se njeriu ka nevojë për rrogë, ama nuk jemi naivë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUQINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes të gjithë, kolegë deputetë, që jeni këtu prezentë në sallë!

Vetëm, para se të filloj të flas, derisa t’i pyes këta kolegë të opozitës - si jeni, a jeni mirë, a u qetësuar, si po ju shkon fushata? Keni kujdes se mos po mbeteni jashtë parlamentit me këtë strategji dhe do të më vinte keq, do të më vinte keq!

Kurse tani, i nderuari zoti kryesues, unë u ngrita për të shprehur mirënjohjen time personale modeste për vendosmërinë e UNMIK-ut, për vendosmërinë e EULEX-it, të KFOR-it dhe të Qeverisë së Kosovës që, më në fund, në atë pjesën veriore të Kosovës të vendoset autoriteti i shtetit të Kosovës. Shpresoj se me këtë intensitet do të vazhdohet edhe në ditët në vijim dhe më në fund të funksionojnë të gjitha institucionet ashtu si duhet në tërë territorin e Kosovës. Kjo ishte një dëshirë dhe një mirënjohje modeste.

Kurse po habitem si disa deputetë, kolegë të nderuar, problemet që i kanë në partitë e veta politike mundohen t’i bartin në Parlamentin e Kosovës, përkatësisht për ato probleme edhe atë pozitë që e kanë mjerane në parti, akuzojnë institucionin e presidentit, Qeverinë e kështu me radhë.

Unë desha vetë t’i them opinionit se mos të bien pre këtyre veprimeve për çështjet madhore, siç është Qeveria, siç është tjera, vendoset në parti, partia merr vendim, asnjë president në botë, asnjë qeveri në botë nuk mund të bëjë politika klienteliste për individë të caktuar, të cilët janë të pakënaqur me pozitën e vet, qoftë në parti, qoftë në shoqëri. Dhe, kaq pata, zoti ju shpëtoftë! Shihemi pas zgjedhjeve, por në rast se vazhdoni kështu, do të na i rritni shumë votat. Mirë u pafshim!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E di që dy deputetët tjerë folën për “Llamkosin”, megjithatë unë kam biseduar personalisht me punëtorët dhe e kam obligim që sot në seancë të përcjell mesazhin e tyre, prandaj deklarata ime e sotme është zëri i këtyre punëtorëve. Janë afërsisht 500 punëtorë të “Llamkosit” të cilët 26 muaj nuk kanë marrë paga, edhe pse kontrata e tyre e punës është e vlefshme deri më 31 gushtë 2010. Ata shpresojnë se ankthi i jetës së tyre të përditshme dhe pasiguria e së nesërme do të përfundojë me angazhimin e Qeverisë dhe të institucioneve të Kosovës për zgjidhjen e halleve të tyre. Në fund të fundit, ata nuk janë fajtorë për dështimin e privatizimit, as për borxhin 10.300.000 euro. Se ky problem duhet të trajtohet menjëherë, dëshmon realiteti i jetës së tyre dhe të familjeve të tyre. Çdo familje e këtyre punëtorëve ka mesatarisht 5 anëtarë, që do të thotë se 2500 shtetas të Kosovës janë pa të ardhura qe 26 muaj. Kjo do të thotë se fëmijët dhe rinia e këtyre familjeve janë të detyruar të ndërpresin shkollimin dhe kanë humbur perspektivën për edukim dhe punësim. Kjo do të thotë 2500 njerëz të Kosovës më të varfër. Gjatë këtyre muajve, punëtorët e “Llamkosit” i janë drejtuar shumë

adresave, duke filluar prej kryetarit të komunës, i cili ju ka thënë se ka biseduar me kryeministrin Thaçi dhe se kryeministri ka thënë se zgjidhjen e çështjes së “Llamkosit” ia ka lënë ministrin të MEF-it, Ahmet Shala, kurse kryeministri dhe ministri Shala në ndërkohë po sodisin prej së largu. Mbase po mendojnë si ta zhvillojnë ekonominë e Vushtrrisë! Dyshoj. Sindikata e Pavarur e “Llamkosit” ka dërguar shkresa në shumë adresa, presidentit të Kosovës, kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, Agjencionit Kosovar të Privatizimit, BSPK-së, ministrin të MEF-it, ministrin të Tregtisë dhe Industrisë si dhe EULEX-it.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Në mënyrë që të kuptoni gjendjen e këtyre punëtorëve, ju propozoj të gjithëve, duke filluar nga kryeministri dhe ministrat, kryetari i Kuvendit apo ushtruesi i detyrës së presidentit, por edhe deputetët dhe kreu i AKP-së që ta vënë veten lëkurën e këtyre punëtorëve dhe të dëgjojnë me vëmendje kërkesat e tyre që po i parashtroj.

E para, nëse nuk mund të privatizohet “Llamkosi”, t’i jepet ndonjë operatori ekonomik.

E dyta, deri në privatizim e mirëfilltë, punëtorëve t’ju sigurohet paga minimale.

Me qenë se zëvendëskryeministri ka premtuar t’i takoj më 14 tetor, unë po i përcjell parullat e tyre: “Kërkojmë punë e bukë”, “Duam paga të garantuara”. Deri në privatizim të drejtë, punëtorët e “Llamkosit” kërkojnë kthimin në vendet e tyre të punës.

Më lejoni të shtroj pyetjen: I kujt është shteti i Kosovës, i qytetarëve apo pushtetarëve? Po e përmbyll deklaratën time me fjalët e punëtorit të “Llamkosit”: “Ta mbrojmë ‘Llamkosin’ sepse është e vetmja fabrikë në Vushtri”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës ka përfunduar. Regjia, t’i regjistrojë të mbeturit, janë 5 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 58 deputetë, që do të thotë janë të plotësuar kushtet për punë. Në fakt, s’janë, se s’ka kuorum, por kësajde në korridore janë, besoj, deputetët. Ju lus, në qoftë se duam ta vazhdojmë seancën, kryetarët e grupeve parlamentare t’i thërrasin deputetët e vet. Kemi, të paktën për ta arrit kuorumin, na duhet edhe 2 deputetë brenda.

Unë, për ta fillua rendin e ditës, duhet t’i kem 61 deputetë në sallë, pastaj vazhdojmë. Okej, pasi nuk po donë të hynë, se janë duke pirë kafe jashtë, vazhdojmë me pyetjet që janë dhe besoj që do të bëhet kuorumi. Ja, edhe një u shtua! A ka dikush jashtë, a mund t’i thoni dikujt të vijë në sallë, a si është puna? Po, zoti Beqiri?

Atëherë, edhe ne po marrim 10 minuta pauzë për kafe, s’kemi çka bëjmë!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare, ju lus që t’i ftoni, t’i thirrni deputetët që janë jashtë salle, në qoftë se jeni të interesuar ta mbajmë seancën!

Faleminderit, të nderuar kryetarë të grupeve parlamentare, për ftesat që ua bëtë deputetëve dhe po vazhdojmë!

Konstatoj që në sallë janë 65 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15 paragrafi 3 dhe nenin 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare. Ndërkohë, deputeti Driton Tali, i përkrahur edhe nga 5 deputetë të tjerë ka parashtruar kërkesë me shkrim për radhitje në rendin e ditës të mbledhjes së sotme plenare - Debat për garancionin bankar të operatorit mobil "Kosmocel".

Në bazë të nenit 42 pika 2 të Rregullores së Kuvendit, unë jam i detyruar ta hedh në votë kërkesën e deputetit, por mendoj që seanca e sotme nuk është e përgatitur për një debat të tillë dhe kisha propozuar personalisht që kjo çështje të shtyhet në procedurë të rregullt, t'i kalojë Kryesisë dhe debati të zhvillohet në seancën e radhës sepse, sipas Rregullores, i plotëson të gjitha kushtet që të shqyrtohet në Kryesi dhe të silltet për debat. A jeni dakord që ta shtyjme për seancën e ardhshme? Okej, faleminderit!

Konstatoj që Kuvendi ka miratuar kërkesën për debat, por sipas Rregullores e ka shtyrë që kërkesa të kalojë, të procedohet nëpërmes Kryesisë. A ka dikush diçka tjetër? Nuk ka tjetër mocion tjetër për rendin e ditës. Konstatoj që u miratua rendi i ditës.

Po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: - Koha për pyetje parlamentare.

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është kufizuar në 60 minuta. E dini që deputeti për një mbledhje mund të parashtrojë më së shumti 2 pyetje.

Po fillojmë me pyetjet e deputetëve. Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministren e Energjisë dhe Minierave, zonjën Justina Shiroka Pula. Ministria s'është këtu. Deputet, a dëshironi ta bëni pyetjen, apo ta lëni, dëshironi ta prisni ministren?

Deputeti Ramadan Gashi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Ministri nuk qenka këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Deputetit Gashi fjalën!

RAMADAN GASHI: faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pse ministri nuk është prezent në këtë seancë, mendoj se është e interesit ta sqarojmë këtë pyetje. Me datën 14 shtator, në Mitrovicë, në koordinim të kryetarëve të komunës së Mitrovicës, Skenderajt dhe të Vushtrrisë dhe menaxhmentit të spitalit regjional, është mbajtur një takim, ku është sqaruar funksionimi real i atij spitali dhe në atë rast është konstatuar se ka një shpërputhje të madhe në mes kërkesave dhe nevojave të qytetarëve dhe shërbimeve të ofruara, që kryesisht është si pasojë e mungesës së personelit mjekësor, për arsye se në atë spital ndihmë kërkojnë rreth 220 mijë banorë, kurse ofrojnë shërbime vetëm 49 mjekë, kështu që është një shpërputhje shumë e madhe dhe krahasuar edhe me spitale tjera regjionale është proporcioni ndoshta 1 me 3 më i pafavorshëm.

Është shqetësuese edhe ndërprerja e gjeneratave të mjekëve dhe personalit atje, kontinuiteti i gjeneratave për arsye se moshë mesatare e atyre mjekëve është 52 vjeç, vetëm 2 prej tyre janë nën moshën 40 vjeçare, kështu që vërtet vërehet një shpërputhje totale. Atë ditë është paraqitur edhe një propozim-plan konkret i menaxhmentit afatmesëm dhe emergjent, të cilin mendoj se ministri e ka sepse ministria ka qenë prezente dhe nëse atij plani i përmbahemi, mendoj se do të zbutet pak

gjendja në atë spital. Ta zëmë, ishte edhe një kërkesë që do të duhej pasur një tretman pak sa më të veçantë me specializantët për atë regjion, përndryshe vërtet ai spital më nuk mund të ofrojë shërbime, ani pse tash është kah punohet në objektet fizike, ani pse janë duke u përgatitur diku rreth 11 mijë metra hapësirë, spitali ka filluar të pasijet...

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Doni ta bëni pyetjen? Deputetët Rustemi, fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Do ta bëj pyetjen vazhdimisht, ky është versioni i dytë i kësaj pyetje, sepse mendoj se çështja e tillë nuk vjetrohet kurrë dhe nëse përsëritet pyetja, vetëdijesohen qytetarët për hajnitë dhe keqmenaxhimet që ndodhin në fushën e shëndetësisë, sepse pyetja i është drejtuar ministrit edhe më parë. Duke pasur parasysh se zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë shumë herë deklarojnë se gjatë procesit të blerjes së barërave buxheti i Kosovës po dëmtohet vazhdimisht, posaçërisht në vitin 2008 dhe 2009, në vitin 2009 skajshëm, shumë, pa marrë parasysh se një sasi shumë e madhe e barërave është blerë me blerje emergjente dhe e meritojnë qytetarët e Kosovës që t'u shpjegohet se pse me blerje emergjente, kur dihet që ndoshta nuk është arsyetim shumë i madh të blihen barërat emergjente, të cilat janë për shfrytëzim ditor, ndoshta, dhe jo për raste emergjente. Sipas të dhënave që unë disponoj, domethënë me të dhëna të shumta nga blerjet e Ministrisë së Shëndetësisë me fatura, lejet janë dhënë nga Ministria e Shëndetësisë në mënyrë të vazhdueshme për blerje kot së koti, ndoshta edhe me çmime qindra herë më shumë se sa në shtetet ku vlerësohen standardet dhe kualiteti i kontrollit. Kur them me qindra, 100/% domethënë, 100%, 200% e 300%. Pyetja i është drejtuar ministrit edhe herën e kaluar, pse nuk keni bërë publike se për sa është dëmtuar buxheti i Kosovës gjatë blerjes së barërave dhe sa janë vlerësimet e juaja paraprake, si ministër i Shëndetësisë, të dëmtimit që i është bërë buxhetit të Kosovës? Buxheti i Kosovës normalisht që dëmtohet kur mungon planifikimi. Menaxhimi me situata emergjente do të thotë mungesë e menaxhimit adekuat dhe mungesë e dijes në planifikim për blerjen e barërave. Kosova përballet me një varfëri të skajshme, qytetarët e Kosovës shkojnë në Qendrën Klinike Universitare, janë të detyruar të dalin...

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri, s'është këtu. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Bukoshi. Dëshironi ta lexoni pyetjen? Deputetët Tali fjalën, ju lutem!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo po ashtu është një pyetje që i është bërë kaheerë zotit ministër, ka të bëjë me një premtim që pati dhënë në seancën e 25 qershorit, kur u pyet, më në fund kur dha përgjigjen për listën e atyre njerëzve, fytyrave publike të cilët kanë uzurpuar pronën e QKUK-së, të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Zoti ministër në atë seancë pati thënë se në shtator do ta publikojë listën, e ne sot jemi më 7 tetor. Është hera e dytë që po e pyes zotin ministër, po s'është këtu. Po ashtu, edhe drejtori i QKUK-së pati premtuar në emision televiziv, në "Pulsi" në Koha Vizion, se listën e atyre të cilët e kanë uzurpuar pronën e QKUK-së do ta bëjë publike së shpejti. Andaj, jam i interesuar që ta dimë se kush janë ato fytyra publike të cilat e kanë tjetërsuar apo shpronësuar pronën publike të QKUK-së, të jepen me emra dhe mbiemra, ashtu siç pati premtuar zoti Bukoshi, ministri Bukoshi, pa anime, domethënë, të gjithë ata, pa marrë parasysh cilit subjekt politik i takojnë apo cilës Qeveri në të kaluar i kanë takuar apo kësaj Qeverie. Ju faleminderit! Unë pres që zoti Bukoshi të na japë këtë përgjigje, përndryshe kjo pyetje do t'i përsëritet derisa ai të dalë apo drejtori i QKUK-së me emrat konkret të atyre të cilët e kanë uzurpuar apo shpronësuar pronën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ministri nuk është. Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Dëshironi ta lexoni? Deputetes Sylja, fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Është e vërtetë që pyetjen ia kam drejtuar kryeministrit, por me qenë se ministri resorit, ministri i Arsimit është këtu, unë kërkoj që ministri të përgjigjet.

Më 1 shtator të këtij viti, kur ka filluar viti i ri shkollor në Kosovë dhe kur disa shkolla kanë bërë grevë njëditore, kryeministri i Kosovës ka ripërsëritur premtimin e tij për rritjen e pagave për punëtorët e arsimit fillor dhe të mesëm. Grupi i arsimtarëve më ka kërkuar të pyes Qeverinë se kur saktësisht do të ketë rritje të pagave të mësimdhënësve? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Dëshironi, zoti ministër, të përgjigjeni? Zoti Hoxhaj e ka fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, i nderuari zoti kryesues i Kuvendit!

Zoti zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

E respektuar zonja deputete,

Gjatë muajit korrik dhe gusht kryeministri i Kosovës dhe unë, si ministër, kemi pasur disa takime me Sindikatën për Arsim dhe atë kohë jemi marrë vesh që të formohet një komision i përbashkët mes Sindikatës për Arsim dhe Ministrisë së Arsimit, e cila do të duhej t'i bënte planifikimet buxhetore për rritje të pagave të mësimdhënësve. Ju e dini që ne në vitin 2008 e kemi bërë një ngritje të pagave në përputhje me kriteret e kualifikimit dhe në përputhje me përvojën e mësimdhënësve dhe falë kësaj rritjeje, realisht ka ndryshuar shumë gjendja në sektorin e arsimit, ka ndryshuar edhe interesimi i të rinjve që të studiojnë në Universitet të Prishtinës. Aktualisht ka 22 deri 25 kandidatë që konkurrojnë për pozitën e një mësuesi në Universitet të Prishtinës. Janë po thuaj se përgatitjet finale të këtij komisioni, do të dalim me një buxhet konkret, e prezantojmë brenda përbrenda Qeverisë, merret vendimi në Qeveri. Mirëpo, në janar do të ketë një rritje të pagave dhe në muajin janar mësimdhënësit do t'i marrin pagat e rritura, meqë është përkushtim i kryeministrit që kjo të ndodhë. Unë ju premtoj që kjo kërkesë do të mund të jetësohet në janar të vitit 2011 në formën se si kryeministri ka premtuar.

KRYESUESI: Faleminderit!

Pyetje shtesë? Po, zonjusha Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, është e qartë që është fushatë, sepse tek keni formuar gupe punuese dhe jemi në muajin tetor, e dihet se buxheti kur kalon dhe si bëhet planifikimi, a realisht ajo nuk mund të realizohet në janar. Sa e keni planifikuar rritjen, ju tregoni mësimdhënësve, saktë sa është kjo rritje? Por, është e qartë se po bëni fushatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hoxha!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Zonja deputete,

Unë e përmenda muajin korrik dhe gusht dhe po ashtu premtimin e 1 shtatorit, i cili s'ka pasur të bëjë me gjendjen aktuale politike në Kosovë. Prandaj, do të ketë një rritje të pagave të mësimdhënësve, pavarësisht prej asaj a mund të thuhet kështu apo ashtu. Është një premtim që është

bërë në vitin 2009, është një premtim që është bërë në vitin 2010, e kemi bërë një rritje në vitin 2008, prandaj rritje të pagave do të ketë. Komisioni i cili është përgjegjës për ngritje të pagave është duke i bërë kalkulimet buxhetore dhe ne e kemi një projekt me Bankën Botërore, ku realisht procesi i zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe licencimi do të shkojë paralelisht me rritjen e pagave. Një gjë ju premtoj, që më 1 janar ose në fund të janarit pagat do të jenë të rritura për vitin 2011.

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Dëshironi ta lexoni pasi s'është kryeministri? Zotit Smaka, fjalën!

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Të nderuar zëvendëskryeministër, ministra, deputetë,

Pyetja është kjo. Çështja: Rimbursimi i dëmeve njerëzore, materiale, të cilat shteti serb ia pat shkaktuar popullit dhe shtetit të Kosovës, veçanërisht gjatë periudhës 1998 – 1999. Çfarë janë politikat qeveritare ndërtuar zhdëmtimeve, rimbursimeve, kompensimeve të të gjitha formave të dëmeve, ka shumë forma, veçanërisht gjatë periudhës së sipërthënë, cilat shteti serb, jo paramilitarët e parapolutarët, por shteti serb hegjemonist ia pat shkaktuar popullit të Kosovës edhe tani, domethënë, entitetit politik shtetëror, shtetit të Kosovës, ju lutem! Unë mendoj, llogaris që zëvendëskryeministri do të më japë një përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Më falni, Riza Smaka, ka edhe një pyetje për ministrin e Drejtësisë, Haki Demolli. Zoti Smaka, e keni fjalën!

RIZA SMAKA: Zoti kryesues, nëse ma lejon një pasazh si pyetje plotësuese, por në favor të saj. Fjala është - Clara pacta, boni amici, dy shtete raporte me konteste të ngarkuara. Ne duhet t'i pastrojmë raportet për ta relaksuar relacionin e shtetit tonë me Serbinë, se nuk është fjala për popullin serb, por për shtetin serb. Kjo është poenta edhe unë angazhohem që kjo temë topike të futet në agjendën e bisedimeve që priten.

Ndërsa pyetja, nëse tani mundem, zoti kryesues, shkurt, kësisoj.

Është fjala për nenin 5 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, i cili e sanksionon barazinë e gjuhëve zyrtare dhe aplikimin e domosdoshëm të gjuhëve zyrtare në vendin tonë, e këtë nuk e përfill dot Dhoma e Posaçme, e Veçantë apo janë të Gjykatës Supreme, që nuk është e Gjykatës as në Gjykatën Supreme, referuar temave të AKM-së. Faleminderit! Çfarë do të kishte mund të bënte Ministria e Drejtësisë në funksion të drejtësisë, këtu është fjala, pyetja?

KRYESUESI: Zoti ministër Demolli, e keni fjalën!

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar zoti kryesues i Kuvendit,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

I nderuari deputet, profesor Smaka,

Para se të përgjigjem në pyetjen tuaj konkrete se çka do të mund të bëjë apo çka mund të bëjë Ministria e Drejtësisë lidhur me neglizhimin e nenit 5 të Kushtetutës së Kosovës nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Unë do të kisha dashur të theksoj që kjo pyetje më shumë korrespondon me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, mirëpo nuk do të thotë se nuk është në sferën e interesit edhe të Ministrisë së Drejtësisë, sepse dihet se konform nenit 108 të Kushtetutës së Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur, i cili siguron që gjykatat

në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale, të paanshme, si dhe të siguron që të bëjë inspektimin gjyqësor dhe administrimin e gjykatave në Kosovës. Mirëpo, vërtet është evidente ajo që thoni ju, i nderuari deputet Smaka, se sipas legjislacionit në fuqi për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në Kosovë për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, më konkretisht në urdhëresat Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/13, 2006/17, 2008/6, parashihet, po citoj se “lutjet, parashtrirat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze”. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha lutjeve dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze. Shpenzimet e përkthimit duhet t’i heq pala. Mirëpo, e njëjta Kushtetutë thekson, apo Kushtetuta e Kosovës, se personat të cilët konsiderojnë se ju është cenuar një e drejtë e tillë, mund të thirren në nenin 113, alineja 7 të Kushtetutës dhe të kërkojnë mbrojtjen nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Në këtë nen, decidivisht përcaktohet se individët janë të autorizuar të ngrehin shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe të lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shtetur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Në fund, do të doja të theksoja se Ministria e Drejtësisë lidhur me përgatitjen e përgjigjes në pyetjen tuaj, i nderuari deputet, është interesuar dhe në Gjykatën Kushtetuese...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë, ministrit!

MINISTRI HAKI DEMOLLI: ... i ka bërë pyetje Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe prej saj ka marrë këtë informatë se aktualisht është duke u zhvilluar një procedurë lidhur me këtë çështje dhe besohet dhe është e pritshme se akti i tillë juridik, si dhe veprimet e tilla juridike që janë konform këtyre akteve juridike, do të shpallen kundër kushtetuese. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje shtesë?

Zotit Smaka, fjalën!

RIZA SMAKA: E mora një përgjigje kompetente në mocionin tim dhe jam i satisfikuar edhe me faktin se në Gjykatën Kushtetuese qenka në procedim kjo çështje irituese, tepër e pa tolerueshme në shtetin e së drejtës, në të cilin ne mëtojmë për të qenë. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Skender Hyseni. E doni fjalën? Deputetes Hadri, fjalën!

TEUTA HADRI: Unë pyetjen do ta bëjë. Shpresoj se ministri në seancën e ardhshme do të ma jap përgjigjen.

Përfaqësues tanë diplomatikë, që punojnë në ambasada, po punojnë me dinjitet shumë të lartë, kur dihet se në çfarë kushte po punojnë.

Pyetja: Deri kur duhet të presin përfaqësuesit tanë diplomatikë që t’ju sigurohen makinat zyrtare, deri kur do të vetëdijesohet administrata që pagat, pagesat dhe shpenzimet e stafit dhe të zyrave t’ju sigurohen që ato të funksionojnë me kohë dhe si kjo administratë do t’i mbikëqyrë shpenzimet që i kanë bërë këto ambasada? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ministri nuk është këtu. Prapë deputetja Hadri, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Nuk dëshironi.

Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Dëshironi ta bëni pyetjen? Jo.

Deputeti Arsim Bajrami, pyetje për ministren Edita Tahiri.

ARSIM BAJRAMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

E nderuara ministre Tahiri,

Pyetja ime ka të bëjë me kureshtjen time për t'u informuar për vonesën e procedimit të Ligjit për Qeverinë. Është një ligj organik që ka qenë edhe obligim kushtetues. Vetëm dëshiroj të përkujtoj që gati po bëhen 2 vite që ky ligj është miratuar në Qeveri, më herët është proceduar në Kuvend, por pastaj është tërhequr bashkë me pakon e ligjeve tjera sistimore për Administratën Publike, Ligjin për Shërbimin civil, Ligjin për pagat, Ligjin për kryeqytetin. Ndër to, këto tri ligje janë proceduar dhe unë dëshiroj të ju pyes - a keni informacion pse po vonohet ky ligj, sepse është një nga ligjet e vetme organike që drejtpërsëdrejti janë detyrim kushtetues për shkak se rregullojnë një sferë të pushtetit, sferën ekzekutive. Ligji, i cili është si draft, ka qenë i harmonizuar jashtëzakonisht mirë me gjithë faktorët relevant, i punuar me standardet më të larta evropiane dhe unë mendoj se është shumë e rëndësishme që gjatë kësaj legjislatore të miratohet ky ligj, në mënyrë që të kompletojmë komplet legjislationin organik dhe ky ligj mos të bartet në legjislaturën e ardhshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Zonja ministres, dëshironi fjalën? Ministrja Edita Tahiri e ka fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Arsim Bajrami,

Së pari, ju falënderoj për pyetjen, sepse aktualizon një çështje shumë të rëndësishme që ka të bëjë me miratimin e domosdoshëm të Ligjit për Qeverinë dhe me këtë rast dua të them se me miratimin e këtij ligji, në fakt, kompletohet korniza ligjore për fushën e administratës publike, duke marrë parasysh që sivjet u miratuan 4 ligje të rëndësishme, dy ligj bazike, Ligji për Shërbimin civil dhe Ligji për pagat e nëpunësve të Shërbimit civil, pastaj u miratua Ligji për Administratën Shtetërore dhe ai i konfliktit administrativ. Për sa i takon ligjit në fjalë, është fakt se me 24 prill 2009, Qeveria e ka miratuar dhe ia ka proceduar Parlamentit. Tash i mbetet Parlamentit që ta miratojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pyetje shtesë? Zoti Bajrami e ka fjalën!

ARSIM BAJRAMI: Unë, edhe një herë po apeloj te ministrja, sepse ajo formalisht është sponzoruese derisa ligji të nënshkruhet nga presidenti, që të përdor tërë autoritetin e saj, të ketë konsultime me Kryesinë e Parlamentit që ky ligj të procedohet, sepse është një ligj shumë, shumë i rëndësishëm dhe mendoj se nuk duhet të vijmë në atë situatë që të shkojmë në legjislaturë të ardhshme pa një ligj të mirë për Qeverinë për shkak se ky ligj në të vërtetë është kupola e

komplet reformës së administratës publike. Nëse ne e kemi përfunduar komplet kornizën ligjore për administratë publike, është shumë e nevojshme që të miratohet edhe ky ligj, në mënyrë që vërtet të krijojmë plotësisht në bazë të re ligjore, bazë e cila është plotësisht me standardet evropiane.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Ministrja Tahiri e ka fjalën!

MINISTRESHA EDITA TAHIRI: I nderuar deputet Bajrami, unë me qëllim ju tregova se ky ligj është miratuar në Qeveri me 24 prill 2009, dhe ju keni qenë ministër edhe 1 vit dhe kjo nuk është miratuar në Parlament. Në qoftë se është fjala që do të duhej të shtyhej, atëherë keni pasur ju një vit kohë për ta proceduar në Parlament dhe, unë po ju them, në këtë periudhë unë iu kam dhënë përparësi ligjeve të cilat ndërlidhen me reformën e administratës publike dhe për këtë arsye kam takuar disa herë kryetarin e Kuvendit të Kosovës, në mënyrë që të kryhen këto çështje. Dhe, mos ta çojmë më tutje, se ju i dini arsyet pse është shtyrë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin Thaçi apo për ministrin Shala. Nuk janë asnjëri këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Fjalën e ka zoti Tali!

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Pyetja ka të bëjë me një përgjigje që pata pas marrë dhe një premtim që pata pas marrë nga zoti ministër më 15 korrik të vitit 2008. Atë kohë e pata pyetur zotin Shala se çfarë do të bëjë Qeveria për ta ndalur kontrabandën me derivate në veri të Kosovës, ku i pata përmendur dy pompa të benzinës që në fushë të Zotit, pa kurrfarë kriteresh shitnin benzinë me çmim shumë të lirë, shumë më të lirë se sa që shitej tjetër kund në Kosovë. Zoti ministër atëherë pati premtuar se me ligjin, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat, Administratës Tatimore do t'i jepet më shumë fuqi, pra do ta fitojë më shumë fuqi për t'i konfiskuar prodhimet pa prejardhje, ngjashëm edhe me futjen e kamerave në pikat doganore 1 dhe 31, ky problem do të fillojë të zgjidhet por, përkundrazi, tash nga dy pompa që kanë qenë në korrik të vitit 2008, janë shumuar dhe janë bërë mbi 10. Disa janë po ashtu të ngjashme, pra, në fushë të Zotit, pa kurrfarë kriteresh shesin benzinë, e disa janë edhe luksoze, andaj do të doja ta pyesja ministrin Shala se kur do të mund t'i realizojë premtimet e 15 korrikut të vitit 2008? Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Bukoshi. Dëshironi ta lexoni, Naim? Zoti Rustemi e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Po e përsëris, ky është versioni prapë i ngjashëm lidhur me barërat. Sipas të dhënave që disponon Ministria e Shëndetësisë, shumë barëra, kryesisht nga vendet fqinje, nga vendi fqinj Serbia, janë importuar me leje të veçantë edhe me blerje emergjente. Pyetja ime i është drejtuar ministrit që të na tregoj që pse me leje të veçantë blerja e barërave nga "Jugofarm" nga "Galenika", domethënë, që nuk janë shumë larg për të ardhur situata që të kemi blerje emergjente. Unë prapë do t'ia përsëris pyetjen edhe në seancën e radhës, përderisa ministri Bukoshi nuk do të japë përgjigje në këtë pyetje, sepse kjo direkt është në përgjegjësinë dhe detyrat e punës së ministrit. Ministri tjetër punë nuk ka, përpos që të përkujdeset për shpenzimin adekuat të parasë publike, për atë edhe është i thirrur. Kështu që të gjithë ministrat të cilësdo qeveri edhe të kësaj Qeverie, janë përgjegjës para popullit të Kosovës, për shpenzimin e parasë publike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju Faleminderit!

Pyetja e fundit, e 14-të, deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

I nderuar zoti ministër,

Edhe përkundër deklarimeve tuaja të shumta dhe të zyrtarëve tuaj të Ministrisë të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, se të gjithë filloristët do të pajisen me tekste të reja shkollore, kjo nuk po ndodh në shumicën e shkollave, i nderuar zoti Ministër, domethënë, kanë kaluar më se katër javë duke pritur tekstet, kështu që nxënësit janë në konfuzion edhe arsimtarët edhe prindërit, madje disa kanë filluar t'i blejnë ato tekste, të cilat u mungojnë.

Ne, mendojmë se kjo është shqetësuese edhe përkundër faktit, unë pyes ku qëndron arsyeja dhe pse ndodh kjo, i nderuar? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju Faleminderit!

Zoti Hoxhaj e ka fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit!

I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ju informoj zonja deputete që, për çështjen të cilën e ngritët ju, është një çështje edhe për ne si Ministri e Arsimit. Deri më tash janë shpërndarë tekstet shkollore për 340 mijë nxënës dhe sipas informatave që ne kemi janë shpërndarë 4 milionë e 200 mijë ekzemplarë, nga klasa e parë deri në klasën e 9-të. Një libër shkollos i cili mungon, është libri Gjuha angleze e klasës së 9-të, i cili realisht nuk ka mbërri që të vijë nga Oksfordi, meqë është Oxford University Press dhe të shpërndahet në shkollat e Republikës së Kosovës.

Dua, po ashtu t'ju informoj që me një udhëzim administrativ të vitit të kaluar, këtë vit tekstet shkollore, një pjesë janë të vjetra, një pjesë janë të reja, meqë në çdo vend të Bashkimit Evropian, praktikohet politika e ruajtjes së teksteve të vjetra dhe ato tekste që mund të përdoren që janë tekste bazike, duhet patjetër të përdoren edhe si të vjetra, kështu që një pjesë e buxhetit ka mund të ruhet falë përdorimit të teksteve të vjetra.

Informatat që na e kemi si Ministria e Arsimit, kanë të bëjnë vetëm me librin e klasës së 9-të të Gjuhës angleze, i cili nuk ka mbërri në Kosovë, por kuptohet që unë jam në dispozicion, e kam edhe një dosje të hollësishme, mund t'ju siguroj dhe ju ta shihni sipas raporteve tona se si duket. S' e përjashtoj mundësinë që në një shkollë të caktuar, drejtori i shkollës, ka bërë kërkesë për më pak libra se sa ka pasur nevojë shkolla. Kjo ka qenë përgjegjësi direkte e drejtorive komunale të arsimit dhe drejtorit të shkollës.

KRYESUESI: Ju Faleminderit!

A ka pyetje shtesë?

Deputetja Maliqi e ka fjalën!

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kam edhe një koment të shkurtër sa i përket çështjeve apo teksteve shkollore. Nuk pajtohem me ministrin se siç po e shoh, ministri nuk ka informata të mjaftueshme, por ajo çka është më shqetësuese, i nderuar zoti Ministër, si e vlerësoni apo si e shihni ju që fëmijët, si shembull konkret

fëmija i klasës së dytë, në qoftë se e merr tekstin e vjetër, po e marrim lëndën e matematikës e gjithë e plotësuar, si do ta zhvillojë ai fëmijë psikomotorikën e tij dhe çfarë cilësie në arsim mendojnë që pret në të ardhmen nga ai fëmijë apo ata nxënës? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti Hoxhaj!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ne si Qeveri e Kosovës për këtë vit i kemi blerë të gjitha tekstet që është dashur të blihen. Tekstet përbëhen nga tekstet bazike dhe fletoret e punës. Nxënësit shkruajnë në fletoret e punës, nuk shkruajnë në tekstet bazike, fletoret e punës të gjitha janë të reja. Mandej në përfundim të vitit shkollor, çdo shkollë, çdo komunë, ku ka mundur drejtori i shkollës ta bartë procesin e teksteve që klasa e tretë t'ia jap klasës së tretë e cila ka filluar vitin shkollor këtë vit, kjo gjë ka ndodhur. Unë kam pas takime me drejtorët e drejtorive komunale të arsimit këtë të marte, kemi diskutuar për 3 orë rresht, dhe informatat që ne i kemi, flasin për atë që shumica e nxënësve ose të gjithë nxënësit i kanë marrë tekstet shkollore të cilat ju duhen. Ka të tillë prindër që mendojnë që nxënësit e tyre nuk duhet ta përdorin një tekst të vjetër shkollor, kjo është zgjedhje vetjake e tyre, por informatat tona flasin për atë që në përjashtim të tekstit të klasës së 9-të të Gjuhës angleze, për të cilën unë si ministër pranoj që ende nuk është shpërndarë se nuk ka mbërri nga Britania e Madhe, të gjitha tekstet tjera shkollore, si i kanë kërkuar drejtoritë komunale të arsimit, si kanë kërkuar drejtorët e shkollave për 1.200 shkolla që ka Republika e Kosovës, për 340.000 nxënës, janë shpërndarë 4 milionë e 200 mijë ekzemplarë në të gjitha shkollat e Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Nuk ka pyetje tjera.

Sipas Rregullores, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit, sipas nenit 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Në sallë janë 61 deputetë. Po vazhdojmë me pikën e tretë:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 23 dhe 30 shtator 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në këto procesverbale? Nuk ka vërejtje. Atëherë, konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 23 dhe 30 shtator.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-037 për dokumentet e udhëtimit

Komisionet plenare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit dhe Kuvendit i kanë propozuar miratimin e amendamenteve të propozuara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, zotin Rustem Mustafa, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

Urdhëroni, zotëri Mustafa!

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, kryesues!

Projektligji për plotësimin, ndryshimin e Ligjit, numër 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit, është miratuar në lexim të parë, në seancën plenare, më 25.6. 2010.

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, është caktuar Komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji.

Komisioni, pastaj ka caktuar Grupin punues dhe referues ka caktuar anëtarin e Komisionit, zotin Basri Musmurati. Grupi punues ka mbajtur takimet e domosdoshme, ku kanë qenë të ftuar përfaqësuesit nga shoqëritë civile dhe organizatat e tjera dhe grupit të interesit për shqyrtimin e këtij projektligji. Ky projektligj ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat ligjore: kuptimin përmbajtjen, procedurat, mënyrën e aplikimit të lëshimit të dokumenteve të udhëtimit, llojet e dokumenteve të udhëtimit dhe vlefshmëria e tyre për shtetasit e Republikës së Kosovës.

Raporti final me rekomandime për këtë projektligj, i proceduar për në Kuvend, përmban gjithsej 8 amendamente.

Unë duhet t'i falënderoj deputetët jashtë Komisionit, sepse kanë qenë të angazhuar edhe nga këto 8 amendamente, dy prej tyre janë nga deputetë jashtë anëtarëve të Komisionit, kanë dhënë kontributin e tyre.

Sa i përket amendamentit 6, i propozuar nga Komisioni për të Drejta dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Komisioni funksional, duke marrë seriozisht këtë temë, e ka shqyrtuar këtë rekomandim dhe nuk ka gjetur përkrahje dhe mendon se neni 7 i Projektligjit për plotësimin e Ligjit për dokumente të udhëtimit, duhet të jetë si në projektligj.

Vlen të theksoj para jush se Komisioni, me konsensus ka miratuar këto amendamente dhe unë mund ta arsyetojë amendamentin 6 të propozuar nga komunitetet, në bazë të shkresave dhe rregulloreve që kemi gjetur në vendin tonë, por edhe në organizatat tjera që kanë ardhur lidhur me këtë projektligj. Komisioni vlerësoi se dispozitat në projektligjin në fjalë, me amendamentet e propozuara ofrojnë një kornizë ligjore lidhur me dokumentet e udhëtimit dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit, me amendamentet e propozuara. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 8 amendamente. Amendamenti numër 6, i propozuar nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, nuk është mbështetur nga Komisioni funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport. Votojmë amendamentet veç e veç.

Amendamenti 1.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6. propozim i Komisionit për Komunitete e Kthim, pa mbështetje të komisionit funksional.

Votojmë, tani.

Nuk miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 8.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Regjia, votojmë tani. Në sallë janë 71 deputetë.

Konstatoj se me 64 vota “për”, 2 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Ju faleminderit!

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për qasjen në dokumentet publike

Siç thashë, në sallë janë 71 deputetë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për qasjen në dokumentet publike dhe Kuvendit i kanë propozuar miratimin e amendamenteve të ligjit. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, zotin Esat Brajshori, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për qasjen në dokumente publike, në parim është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në seancën plenare të datës 17 qershor 2010. Komisioni ka përgatitur raportin me rekomandime, më 28 korrik 2010.

Projektligji përmban 27 nene, përmban dispozitat e përgjithshme ku përfshihet: qëllimi dhe fushëveprimtaria e ligjit, trajtimin e kërkesave, mos përgjigjen e autoritetit publik, procedurën e

rishikimit, format e qasjes në dokumente, refuzimin e qasjes në dokumente, dokumentet e publikuara me iniciativë të autoriteteve publike, organin e pavarur për qasje në dokumente publike, zbatimin, raportet, pagesat për qasje në dokumente zyrtare dhe dispozitat tjera kalimtare, përfundimtare.

Komisioni pra, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2010, gjithashtu ka shqyrtuar raportet e komisioneve kryesore në lidhje me projektligjin në fjalë dhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka pasur vërejtjeje për amendamentin 19 dhe 24, të cilat vërejtje Komisioni funksional i ka përkrahur. Komisionet tjera kanë qenë që projektligji të procedohet dhe të miratohet në seancë plenare. Nuk na ka ardhur ndonjë amendament dhe unë i thërras deputetët për votim. Ju faleminderit, shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport.

Amendamenti 1.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Zotëri Hajdaraj e ka fjalën për amendamentin 3.

ADEM HAJDARAJ: Kthim nëse bën, se është krejt pa lidhje kjo. Pas nenit 4.2, shtohet paragrafi 3, me tekst: “Kërkesat e kërkuarit” për qasje në dokumente, s’ ka nevojë “kërkesat e kërkuarit”, por kërkesat në dokumente publike, jo kërkesat e kërkuarit, sepse s’ mund të jenë kërkesa tjera të tjetërkujt, por vetëm kërkesa. Nëse bën ta ndërrojmë këtë mirë, nëse jo.

KRYESUESI: Ju faleminderit, profesor!

Mendoj që duhet t’i nënshtrohet lekturës, vërtet kemi probleme me drejtshkrimin e gjuhës shqipe në ligje dhe në dokumente. Besoj që do ta kenë parasysh.

Atëherë, votojmë me vërejtjen e deputetit.

Amendamenti 3.

Votojmë, tani

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 17

Amendamenti 18.
Votojmë, tani

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë, tani

Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë, tani

Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 26.

Në sallë janë 72 deputetë.

Votojmë tekstin në përgjithësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tani.

Konstatoj se me 65 vota “për”, 4 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi miratoi Ligjin për qasjen në dokumentet publike. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 6 të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin e mbrojtjes së konkurrencës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimi e tij me amendamentet e proceduara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Myzejene Selmani apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

Deputetja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe për deputetët që janë prezentë në këtë seancë.

Duke marrë parasysh se në Grupin punues, kryesuese e Grupit punues ka qenë zonja Sala Berisha-Shala, por në mungesë të saj, sot unë do të marrë komentimin për çështjet e Raportit me rekomandimet për Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me nenin 57, 67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjet e mbajtura me 28.9.2010 dhe me 6.10.2010, shqyrtoi Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës, të propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë raportin me 38 amendamente. Mund t'ju them se opinionet e të gjitha komisioneve kanë qenë të mira se Ligji nuk ka problem gjatë amendamentimit me Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, me Komisionin për Buxhet dhe Financa, me Komisionin për Integritet Evropian, Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimit, Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Presona të Pagjetur dhe Peticione.

Kërkoj nga deputetët që të votohen rekomandimet e komisionit funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Siç u njoftuat, janë 38 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport.

Amendamenti 1.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 13

Amendamenti 14.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë, tani.
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë, tani:
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 20

Amendamenti 22.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Votojmë, tani.

Miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Votojmë, tani:

Miratohet amendamenti 38.

Ju njoftoj se në sallë janë 72 deputetë. Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tani.

Ju faleminderit!

Konstatohet se me 66 vota “për” 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës.

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë për votimin e amendamenteve, ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Myzeje Selmanin, apo raportuesin e Komisionit që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Fjalën e ka zotëri Ethem Çeku, raportues i Komisionit.

ETHEM ÇEKU: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit punues t’ju ftoj që ta votojmë këtë projektligj në leximin e dytë. Janë bërë një numër amendamentesh të cilat i kanë plotësuar them Ligjin që të jetë sa më funksional në

zhvillimi ne sektorit të energjisë në përgjithësi dhe në veçanti të sektorit të energjisë elektrike. Amendamentet të cilat janë bërë, janë në harmoni edhe me komisionet tjera parlamentare dhe besoj që kolegët deputetë do ta votojnë unanimisht këtë projektligj, i cili them edhe një herë i nevojitet mjaft sektorit të energjisë elektrike në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Çeku!

Për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 23 amendamente nga Komision funksional. Ne po fillojmë votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë, tani.

Kalon amendamenti 1.

Ju njoftoj që në sallë janë 63 deputetë

Amendamenti 2.

Votojmë tani.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë, tani.

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë, tani.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë, tani.

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani.

Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë, tani.

Kalon amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë, tani:

Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë, tani:

Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë, tani.
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë, tani.
Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë, tani.
Kalon amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë, tani:
kalon amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 18

Amendamenti 19.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë, tani
Kalon amendamenti 21.

Amendamenti 22.
Votojmë, tani:
Kalon amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë, tani:

Kalon amendamenti 23.

Tash bëhuni gati ta votojmë ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet që sa po i votuam. Regjia gati, dhe deputetë, votojmë tash.

Në sallë janë të pranishëm 66 deputetë.

“Për” kanë votuar 57, asnjë “kundër”, 2 abstenime. Konstatohet që u aprovua Ligji për energjinë.

Pushim për drekë deri në orën 14:00.

Vazhdimi i punës së seancës pas pauze

Drejtimi i seancës e merr anëtarin e Kryesisë, zotëri Xhavit Haliti

KRYESUESI: Po kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike

Në sallë janë 63 deputetë, ka kuorum për ta vazhduar punën.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë elektrike dhe Kuvendi ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Tregti, Energjetikë, Transport, Telekomunikacion, Myzeje Selmani ose raportuesin e Komisionit, Ethem Çeku që ta marrë fjalën.

ETHEMÇEKU: Ju faleminderit, nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ky është në pakon e ligjeve të energjetikës të cilët janë sjell në leximin e dytë e theksuat, janë 37 amendamente. Mendoj është një nga ligjet e rëndësishme që duhet të vendosë një rregull në sistemin e energjetikës në Kosovë dhe dihet për shumë vite, ky sistem është duke mos mundur të ecën ashtu siç duhet për shkak të natyrave të ndryshme, por njëra nga natyrat më të rënda është mospagimi i energjisë elektrike, do të thotë është një ligj që i vendos edhe, caku i këtij ligji për t'i vendosur që t'i zgjidhë definitivisht problemet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e sektorin e energjisë elektrike.

Në këtë drejtim, ka pasur shumë diskutime edhe me komisionet tjera. Unë, dua të kërkoj që ky ligj të aprovohet, kurse tek neni 39 i kemi 2 amendamente, vërtet e kemi një amendament nga dy komisionet që ka të bëjë me sanksionet për vjedhjen e energjisë elektrike, do të thotë, në atë mund, pastaj të diskutojmë kur të vijmë te neni 39 që të mos diskutojë tani. Do të ftoj që ky ligj të aprovohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

E tha edhe anëtari i Komisionit funksional lidhur me rëndësinë e këtij projektligji dhe ne si Komision për Buxhet dhe Financa, kemi shqyrtuar dhe kemi konstatuar se ky projektligj, amendamentet e këtij projektligji duhet të miratohen sot në Kuvend, për shumë arsye në të cilat nuk do të dua të hyjë. Dua ta shfrytëzoj këtë rast dhe të jap personalisht një vërejtje të cilën e kam dhënë edhe në legjislaturën e kaluar, për sa i përket, e përmendi edhe zoti Çeku nenin 39, që është një nen i ri që korrespondon me amendamentin 35 lidhur me cilësimin si vepra të veçanta të vjedhjes, vjedhjen e energjisë elektrike dhe unë e konsideroj se kjo është në kundërshtim me të drejtën penale, sepse Kodi Penal përcakton vjedhjet dhe është edhe Kodi i Procedurës Penale përcakton pastaj shkallët ose dëmet që mund të shkaktohen nga vjedhjet dhe mbi bazën e saj, pastaj cilësohen dhe si vepra të rënda ose vepra të lehta penale.

Në qoftë se ka qenë arsyeja e mos pagesës ose mos inkasimit të energjisë elektrike, pikërisht për shkak se është thënë disa herë se ka një zbrazësi juridike për sa i përket atyre që abuzojnë me energjinë elektrike, kjo nuk është e vërtetë, absolutisht. Të gjitha gjykatat kanë pasur të gjitha kushtet dhe të gjitha dispozitat që të veprojnë dhe zbatojnë aty ku ka keqpërdorim dhe vjedhje të energjisë elektrike dhe si e tillë, ne sikur po i futem një praktike që edhe për vjedhje tjera, po them tash vjedhjet e bankave cilësohen si vjedhje të veçanta, vjedhjet e pompave të benzinës, vjedhja e ujit, pastaj ose kyçjet ilegale që megjithatë është shkelje, është vepër penale që cilësohen si kyçja në rrugë, si kyçje ilegale ose vepër penale dhe kështu neve nuk na duhet Kodi Penal absolutisht, sepse të gjitha dëmet që shkaktohen nga veprimet e tilla, po përcaktohen me ligje të veçanta që rregullojnë një fushë të veçantë. Prandaj, unë mendoj se neni 39, respektivisht amendamenti 35, te pika 7.1 nuk duhet të jetë kështu siç është propozuar, sepse është vetëm Kodi Penal dhe gjykata që merret me veprat penale, që e cilëson edhe shkallën e dënimit. Nuk mund të thuhet në asnjë ligj se në qoftë se vjedh mbi 5.000 euro ti dënohesh me 3 muaj deri në 6 vjet, sepse është gjykata që e vlerëson edhe atë shkallën e vjedhjes, dëmin që është shkaktua nga vjedhja dhe rrezikun e vjedhjes që është bërë.

Unë po them para katër vjetëve, në legjislaturën e kaluar, dikush që ka propozuar ka pas marrë shembull pse vjedhja e pyjeve është vepër e veçantë penale, dhe këtu ka arsye pse vjedhja e pyjeve është vepër e veçantë penale, sepse për një dru për të ardhur në gjendjen e mëparshme, ajo që quhet restitucio, i duhen 50 vjet ose 20 vjet. Prandaj, kjo ka qenë arsyeja, ndërsa te energjia elektrike, në moment që konsiderohet që është bërë vjedhja, mund të vlerësohet dëmi dhe mund të lidhen telat ndryshe dhe është rikthim në gjendjen e mëparshme, mos të fusim një praktikë që për çdo çështje dhe për çdo veprim të kundërligjshëm ne të caktojmë me ligje tjera jashtë Kodit penal dhe jashtë Kodit të procedurës penale edhe shkallën e dënimeve edhe vlerësimet për veprat penale.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bahri Hyseni është paraqitur për fjalë.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne pikërisht për këtë nen që e tha pak më parë edhe deputeti Gani Koci, si komision kemi nxjerrë një raport dhe nëse lexohet me vëmendje, tash në raportin përfundimtar të komisionit ka ndryshuar radhitja e amendamenteve dhe është një situatë që e kemi vështirë... për shkak të ndryshimit të raportit përfundimtar, por po e lexoj raportin që e kemi bërë si komision dhe që nuk po e shoh që është përfillur, kështu po them, nga komisioni funksional, edhe pse unë kam pasur rastin të bisedoj edhe me ekspertin. Mirëpo, paraprakisht vetëm ta diskutojmë.

Çështja ka qenë... tri problemet të cilat i kemi diskutuar si komision, të cilat duhet domosdo të ndryshohen, e para ka qenë, janë thirrur në referencat e Kodit të përkohshëm penal dhe ne kemi

sugjeruar që të mos quhet kod i përkohshëm, se Kuvendi e ka aprovuar si Kod penal i Kosovës dhe kjo i përkohshëm, nuk duhet. Është çështja e parë.

Çështja e dytë ka qenë, janë thirrur në referencat, në nenet 317 dhe 319 dhe, për njoftim, ne kemi sugjeruar që të mos thirren në nenet sepse Kodi penal është në ndryshim e plotësim dhe mund të ndodhë që të ndryshojnë referencat, siç ka ndryshuar raporti që e kemi para vetes dhe mandej të mos biem në situatë që për çdo ditë t'i ndërrojmë ligjet. Është çështja e parë.

Çështja e dytë, që kemi referuar, është në kreun V, janë thirrur në kreun V të Ligjit apo të Kodit penal të Kosovës, që janë thirrur gabimisht, ka qenë ndoshta edhe gabim teknik, sepse kanë menduar të thirren në Kodin e procedurës penale. Kreu V flet për riatdhesim, flet për rehabilitim të dënuarve politikë, jo për... Mirëpo, këtë e kemi sqaruar dhe besoj që e kanë ndryshuar.

Kurse, çështja e tretë që kemi kërkuar, ne pajtohemi që edhe me ligje specifike, po flasim tash në aspektin profesional, mund të cilësohen vepra penale, sepse edhe Kodi penal nuk mund të jetë, t'i parasheh të gjitha veprat penale. Mund të specifikohen si vepra penale, por vërejtjen e kemi, nuk ka mundësi në çdo ligj të thuhet që nëse e bën këtë vepër, ke për t'u dënuar 3 muaj, 5 vjet ose 3 vjet, sepse ekziston edhe procedura penale, ekziston edhe verdikti i fundit i gjykatave dhe atë e përcaktojnë, e kualifikojmë veprën penale dhe mandej vendosin për dënimin.

Nuk do të ishte e mundur që 300 ligje të jenë ligje specifike dhe tash çdo kund të ketë 3 vjet, 5 vjet. Për këtë e kam pasur një diskutim të hapur me një ekspert, por nuk ishte e mundur të... Ne mund të parashohim, por situata është që nëse parashohim 3 muaj dhe 5 vjet, ne nuk e dimë organizimin, nuk e dimë kodin si ta organizojmë dhe vjedhja i ka dy cilësime në kod penal, vjedhje e rëndë, vjedhje e lehtë, vjedhje që i shkakton dëm tjetrit, prandaj gjithçka që mund të cilësojmë tash si vepër penale, me siguri nuk arrijmë të parashikojmë më mirë se prokurori publik apo institucioni përkatës. Dhe, kjo ka qenë arsyeja që të mos parashihi vitet e burgimit, por le të mbetet në duar të ekspertëve dhe atë do ta cilësojnë vepër penale të vjedhjes, a është vepër penale e qëllimshme, a është vepër penale e cila ka shkakuar dëme materiale e kështu...

Këto kanë qenë tri rekomandimet dhe sugjeroj që, jo për çështje tjera, por të pranohen sepse do të ishin me interes që të kemi vetëm një ligj më të mirë dhe kurrëgjë tjetër. Faleminderit!

KRYESUSI: Unë po çuditë pse s'i keni bërë amendamente, por rekomandime. Megjithatë, është sugjerim... Po mirë, mirë, keni mund t'i bëni amendamente dhe i kishim rrethuar. Mirë! Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, kryesues!

Realisht, unë isha i mendimit që ta diskutojmë këtë amendament kur t'i vjen radha në amendamentin 38, a 39, sa është atje me radhë dhe ta diskutojmë bashkërisht, por pasi kolegët i ngritën këto çështje që në fillim, mendoj që është i gabuar koncepti rreth... se nuk duhet të sanksionohet me ligj vjedhja e energjisë elektrike. Ne i kemi, veprat penale të parapara me kod penal cilat janë veprat e parapara dhe na jemi pajtuar me komisionin funksional që Bahriu i përsëriti, i ripërsëriti disa, me dy të parat, por i vetmi dallim në mes neve – komisionit funksional dhe dy komisioneve, jo vetëm Komisionit për Legjislacion, por edhe komisionin tjetër nga Rexhepi që është ngritur, është që të mos përcaktohet koha e dënimit për vepër penale, a duhet të jetë nga 1 deri në 3 vjet apo duhet t'i lihet gjykatës për të marrë vendim. Nga të gjitha konsultimet që i kemi bërë edhe me Kodin penal, që ky përcaktim i dënimit nuk bie ndesh me Kodin penal. Nuk bie ndesh me Kodin penal! Në Kodin penal nuk është e sanksionuar vjedhja e energjisë elektrike. Ne kemi të bëjmë edhe me investimet dhe me

investitorët e jashtëm. Do të thotë, është tepër e rëndësishme që të hyjë, të sanksionohet vjedhja e energjisë elektrike si vepër penale dhe të sanksionohet koha e veprës penale për arsye të cilat ne i cekëm. Kjo nuk bie ndesh. Edhe Komisioni Legjislativ ka thënë që nuk bie ndesh. E vetmja gjë që bie ndesh është se a duhet të vendoset afati kohor me Ligjin për energji elektrike. Vjedhja, nëse cilësohet, duhet të ketë dënim nga 1 deri në 3 vjet. Ky është dallimi. Nuk ka dallime të tjera në mes komisionit tonë dhe komisioneve të cilat i kanë ngritur këto rekomandime, që nuk janë amendamente, por janë rekomandime. Unë mendoj që duhet t'ia lëmë Parlamentit që ta marrë një vendim dhe nga praktika e ligjeve të cilat i kemi aprovuar dhe të cilat i kemi në shqyrtim, edhe ligjet tjera e sanksionojnë kohën që ka të bëjë me vepra penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Një minutë, Bahri Hyseni e ka për një sqarim shtesë.

BAHRI HYSENI: Është e vërtetë ajo që e tha raportuesi. Domethënë, janë inkorporuar të gjitha dhe tani më nuk kemi vërejtje për amendamentin 39. Vërejtja e vetme është a ta lëmë 3 muaj dhe 5 vite burgim, apo ta lëmë pa 3 vite burgim, por ta lëmë të dënohet sipas vendimit të gjykatës. Kjo është çështja. Vërejtje tjetër nuk ka. Janë inkorporuar dhe është përmirësuar ajo për procedurën penale, është inkorporuar edhe... referencat janë eliminuar, janë lënë për kodin, nuk ka vërejtje tjetër. Kjo le të mbetet çështje e Kuvendit. Nuk është dert edhe nëse mbetet, nuk bëhet nami, por ne po sugjerojmë që ndoshta është më rregull mos t'i përcaktojmë vitet e burgimit sepse i përcakton gjykata, por nëse bash duhet, le t'i lënë, unë s'e kam asnjë pengesë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: O, zoti kryesues, unë po i bashkëngjitem diskutimit, edhe pse u morëm vesh ndryshe, për shkak të shpjegimeve dhe insistimit që të jepen vlerësime, unë mendoj aspak parimore, që u dëgjuan këtu nga disa kolegë. Komisioni ka punuar gjatë, me shumë përkushtim në këtë projektligj, jo vet, por me shumë komitete tjera vendore dhe të jashtme, dhe kur kemi ardhur te kjo çështja tjetër, mendoj që e ka peshuar arsyeshëm dhe shumë me vend atë që u tha edhe nga zoti Çeku lidhur me specifikimin, kategorizimin se çfarë nënkupton vjedhja e energjisë elektrike. Pse ajo nuk është vepër penale? Është vepër penale. Të prodhosh energjinë elektrike, ndoshta druri bëhet për 20 vjet, veç thëngjilli nuk bëhet për 20 vjet. Duhet për të kaluar mijëra vjet, pra, që të marrë një trajtë të tillë. Kështu që krahasime të tilla nuk bëjnë. Kodi penal, po ta lexojmë mirë, ata që janë juristë dhe që po flasim këtu, po u thonë tjerëve - ju nuk e dini, merreni lexoni ligjin – Kodin penal çka thotë: lejohet pra që me ligje tjera të rregullohen në mënyrë specifike çështjet të cilat trajtohen. Shikoni, origjinal thotë kështu. Dhe ne, duke e pasur këtë parasysh, kemi bërë propozimin e caktuar, por edhe vërejtjen e caktuar parimore, sepse në fund kemi harmonizuar atë që e tha Bahriu dhe plotësisht është me vend. Nuk ka kurrfarë keqkuptimi më brenda këtij ligji ose dallimi, sepse ne i kemi harmonizuar saktë, vepër penale, e cila do të trajtohet në pajtim me Kodin penal. Hiqen fjalitë, ku janë 1 vjet, 2 vjet, 3 vjet e tjera, por qysh është në Ligjin penal, ashtu... Unë nuk po shoh diçka tjetër, prandaj mendoj që komentet që u thanë janë pa vend dhe unë absolutisht mendoj që komisioni ka bërë punë të mirë, i ka harmonizuar dhe aspak nuk ka nevojë tash të krijohen këtu vlerësime e mendime tjera, që nuk qëndrojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Koci, një minutë!

GANI KOCI: Askush nuk thotë dhe nuk e tha që vjedhja e energjisë elektrike nuk është vepër penale dhe do të gabonte ai që thotë se çdo vjedhje është vepër penale. Çështja ekziston në atë, cilësimi si vepër e veçantë penale apo në kuadër të vjedhjeve si vepër e përgjithshme dhe është gjykata pastaj që ndanë dënimin mbi bazë të shkallës së dëmit që e ka shkaktuar. Vepër penale është, vepër penale

është nëse vidhet edhe një cent, edhe një kaci nëse vidhet diku që s'është e jotja, është vepër penale. Por, jo e cilësuar si vepër e veçantë penale. Ky është problemi dhe aq më tepër ajo që u tha edhe këtu, që nuk do të duhej që ligjet tjera të përcaktojnë shkallën e dënimit, kufijtë prej deri, është Kodi penal, janë procedurat, është vlerësimi i shkallës së rrezikshmërisë që e përcakton këtë nivel, nga 1 deri në 5, nga 6 deri në 3. Këto nuk do të duhej me ligje tjera dhe me çdo ligj tjetër... Kjo është ajo që unë desha ta them, sepse ne na ngarkohen dhe ata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryesues!

Shumë shkurt! Definitivisht, ka shumë rëndësi që kur bëhet fjalë te sanksionet, në projektligje të caktuara e sidomos në ligje sistimore që kanë të bëjnë për sektorë që rregullojnë fusha dhe sektorë, jo veprimtari të sektorëve, të inkorporohen sanksionet nga Kodi penal i Kosovës dhe kjo të inkorporohet dhe të jetë një rregull, sepse kemi pasur problem edhe në komisione tjera. Bile në një ligj të fundit nga komisioni që unë e kryesoj, i kemi hequr fare sanksionet duke u bazuar që Kodi penal i Kosovës e përcakton, janë ekspertët, është gjyqësori dhe janë vlerësimet adekuate nga institucionet profesionale dhe duhet ta krijojmë një kulturë të tillë, një linjë lineare që vërtet të gjitha këto që parashihen ose ligjet të kenë shtojca të caktuara të cilat janë të bazuara në Kodin penal, sepse vërtet po humbim kohë dhe nuk po jemi substancial. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Tashmë u thanë, por thelbi është që ne kemi të bëjmë komplet me nenin 39 dhe ndryshimi apo qëllimi që është dhënë, kualifikimi i veprës penale nga komisioni funksional shihet si qëllimmirë, po këtu edhe paragrafët përpara lidhen me paragrafin 7, që nënkupton automatikisht kualifikimin e kësaj vepre penale, prandaj këtu për t'i rënë shkurt, duhet të hiqet vetëm kualifikimi i veprës penale e gjitha tjerat dhe të thirren në Kodin penal pa u ndarë në nene të caktuara, sepse kodi ndryshohet. Dhe, nuk kemi nevojë ta zgjasim. Kualifikimi i veprës penale duhet të hiqet, ajo mbetet vepër penale sipas Kodit penal dhe Kodit të procedurës penale.

KRYESUESI: Deputeti Gani Buçinca e ka fjalën.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ju dëgjova me vëmendje dhe t'ju them të drejtën, më befasoi kjo dispozitë në ligjin përkatës.

Veprat penale duhet të... kualifikimi i një vepre penale dhe dënimi për të duhet të kalojë vetëm nëpërmes gjykatave. Nuk mundet një korporate ose një subjekti afarist t'i jepen aso ingerencash që të kualifikojë veprën, vjedhjen si vepër penale dhe të sanksionojë edhe dënimin për këtë vepër.

Ne mundemi për vepra për kundërvajtje ndoshta t'i japim një korporate ingerencë për një gjobë administrative, mirëpo kur bëhet fjalë për vepra penale, atëherë vepra penale duhet të marrë dënimin e merituar në një proces gjyqësor, ku është edhe organi i akuzës, edhe i mbrojtjes edhe gjyqtarët. Kështu që është një prejudikim, është një diksion juridik shumë arbitrar dhe antidemokratik dhe bie ndesh edhe me të drejtat e njeriut.

Si do ta kualifikojmë ne veprën kur korporata energjetike i ngarkon qytetarët në mënyrë paushall me borxhe, për shembull. Dhe nuk ka konsumatori asnjë mundësi të kontestojë fakturën, për shembull. Një kësi dispozite ligjore, besoj se do të keqpërdoret prej korporatave dhe nuk do të duhej ta lejonim absolutisht. Mund të jetë ndonjë gjobë administrative për kundërvajtje, mirëpo në asnjë mënyrë që një vepër penale mos të marrë dënimin, mos të vendoset për dënimin e veprës penale korporata qoftë private, qoftë shtetërore. Kështu që mua ma merr mendja se duhet të shkruhet në dispozitë që vjedhja duhet të trajtohet sipas ligjit... sipas Kodit penal të Kosovës dhe për këtë vendos gjykata kompetente në Prishtinë, ose në Prizren, ose në Gjakovë. Kaq, ju lutem! Ky është mendimi im.

KRYESUESI: Deputeti Zef Morina e ka fjalën.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se komisioni funksional mjaft mirë e ka analizuar dhe unanimisht kemi dal me një qëndrim i cili është i paraqitur edhe në amendamentin të cilin e kemi dhënë.

Meqenëse Kodi penal, neni 6 thotë kështu: vepra penale është vepër e kundërligjshme, e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën gjë në ligj është paraparë sanksioni penal ose masat e trajtimit të detyrueshëm, kështu që në amendamentin që komisioni ynë e ka dhënë shumë qartë, shihet dhe kjo sanksionohet në momentin kur ka vjedhje serike, jo një vjedhje e rastësishme, por në qoftë se ka pasur vjedhje përnjëherë, ka bërë vepër penale, një herë sanksionet janë me të holla, të dytën herë gjithashtu, ndërsa nëse ka keqpërdorime të njëpasnjëshme, atëherë parashihet një dënim deri në tri vjet. Këtë gjë e lejon Kodi penal, andaj është shumë e kuptueshme dhe mendoj se është e arsyeshme që të parashihet pikërisht në ligj dhe shumë lehtë pastaj gjykata do të vendosë se a do ta dënojë 1 vjet, 2 vjet a 3 vjet. Prandaj, unë mendoj se ky amendament duhet të ekzistojë, sepse Kodi penal nuk e pengon, domethënë nuk është në kundërshtim me Kodin penal të Kosovës.

KRYESUESI: Unë mendoj se shumica për të njëjtën gjë po flasin. Deputeti Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi kemi diskutuar rreth këtij neni dhe jemi pajtuar njëzëri, gjithashtu, se nuk ka mundësi që të dallohet një hajn që e vjedh një shitore me një hajn që e vjedh rrymën. Hajni, si ai që e vjedh një shitore, si ai që e vjedh rrymën, është hajn dhe nëse e vjedh një shitore, dënohet në bazë të Kodit penal të Kosovës, ai që e vjedh rrymën dënohet në bazë të një ligji të veçantë, ne në njëfarë forme po e ngarkojmë me ligje ose po biem në kundërshtim nganjëherë me Kodin penal të Kosovës.

Nuk ka vjedhje të rastësishme. Vjedhja është vjedhje, si e rastësishme, është vjedhje. Po ka recidivist, përsëritës të veprës penale. Dhe nëse ka recidivistë, përsëritës të veprës penale qoftë për vjedhje të shitores, qoftë për vjedhje të energjisë elektrike, ai do të dënohet në bazë të Kodit penal të Kosovës, respektivisht si të gjithë hajnat tjerë. Prandaj, këtu nuk ka ndonjë të keqe, hajni i energjisë të ketë ndonjë dallim me hajnin tjetër që në Kosovë, që kemi mjaft. Këtu, do të thotë, është problemi. Ne s'po i sanksionojmë ata hajnat që po i vjedhin tenderët, por po mundohemi t'i sanksionojmë me ligj të veçantë ata që po e vjedhin energjinë elektrike, e që s'kanë para për të paguar. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, në Komision për Legjislacion jemi dakorduar pak më ndryshe seç u tha këtu, sepse janë disa çështje të cilat nuk mund t'i përfshijë ky projektligj, ky ligj, sepse përcaktohen me Kodin penal dhe po i them komisionit, së paku në dy raste ka ndërhyrë në një fushë e cila nuk i takon. Neni ose paragrafi 1.7, ku thotë se çdo person që sulmon ose merr pjesë në një grup dhe përcakton pastaj se çfarë... është një kod i veçantë atje, i cili sanksionin për personat që pengojnë ose sulmojnë punëtorët në detyrë zyrtare dhe ky ligj nuk mundet të përcaktojë se çfarë vepre dhe me sa dënohen.

E dyta, po ashtu, paragrafi 1.8, thotë për “personat që ofrojnë ndihmë ose inkurajojnë një person tjetër për kryerjen e veprës penale...” dhe pastaj thuhet, “dënohen në bazë të paragrafit 7”. Po ashtu, edhe për personat që inkurajojnë ose ofrojnë ndihmë, në Kodin penal përcaktohet se sa e cili është dënimi për ta.

Unë konsideroj se ky nen ose ky amendament duhet edhe një herë të rishikohet, që të jetë në pajtim me Kodin penal dhe me ligjet e tjera, sepse nëse kalon kështu çfarë është, atëherë do t'i ndërhyjë Kodit penal drejtpërdrejt, sepse janë vepra që kualifikohen me Kodin penal dhe nuk do të duhej të ishin në këtë ligj. Sepse, në Kodin penal thuhet “për personat që pengojnë dikë, një person zyrtar, ka vepra të dënueshme deri në 5 vjet”, ndërkaq këtu janë sanksionuar me 3 vjet. Prandaj, nuk do të duhej t'i ndërhyjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues! Duke marrë parasysh se u dhanë komente edhe nga të gjithë deputetët e komisionit parlamentar të cilët kanë punuar në këtë projektligj, dhe njëkohësisht u dhanë komentet nga kryetari i Komisionit për legjislacion që e lë pjesën e tretë, a ka mundësi të dënohet prej 3 muajve deri në 3 vite burgim, atëherë kisha kërkuar si kryesues i kësaj seance të qitet në votim raporti dhe kur të vjen te kjo pikë pastaj të shihet a votohet prej 3 muajve deri në 3 vite dhe jo të bëhet diskutim se nuk është shqyrtim i parë i projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Me rregullore, kanë të drejtë deputetët për çdo amendament të marrin fjalën. Ramadan, a u tërhoqe, a? OK. Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që shumicën e gjërave i thanë kolegët para meje. Unë dëshiroj ta shtroj një çështje në parim këtu, në Kuvend. Në vazhdimësi kemi përplasje në mes komisioneve të ndryshme se cili ka të drejtë e cili nuk ka të drejtë. Duhet të specifikohen dënimet me ligje të veçanta apo duhet kjo të jetë ekskluzivisht me Kodin penal të Kosovës. Unë mendoj që Kuvendi duhet ta shqyrtojë këtë çështje me një pikë të rendit të ditës të veçantë, në një mbledhje të ardhshme, që të mos na ndodhë tërë mandati të na shkojë me përplasje në mes komisioneve duke menduar se njëri komision ka të drejtë apo tjetri nuk ka, e tjera.

Mendoj që duhet ta marrim një vendim si Kuvend, në parim, që eventualisht të gjitha çështjet që parashihen për dënime penale të jenë të rregulluara vetëm me Kodin penal, ose që të mundësohet që edhe me ligje tjera specifike të parashihen dënime penale, që ndodh në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian. Domethënë, shumica e vendeve të Bashkimit Evropian, përveç me kodin penal, kanë paraparë dënime edhe me ligje tjera që rregullojnë një fushë specifike, e që mendoj se nuk është ndonjë gabim. Pra, unë propozoj që Kuvendi të marrë një qëndrim dhe të mos kemi nevojë tërë mandatin të humbim energji se cili komision ka të drejtë e cili jo. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që janë ekzagjeruar të gjitha diskutimet edhe lidhur me nenin – amendamentin në fjalë. Në përgjithësi, diskutimet janë pothuaj se me sugjerime të përafërta. Në fund, kur të vijmë te amendamenti, do t'i votojmë çështjet të cilat janë kërkuar të hiqen dhe atë pjesën që e kanë sugjeruar pothuaj se të gjithë diskutuesit, ta heqim. Është fjala për çështjen e penalitetit kush do të dënojë, ligji penal apo ligji i veçantë të cilin po e trajtojmë.

Atëherë, vazhdojmë me votimin. Në sallë janë 69 deputetë.

Votojmë amendamentin 1 të Projektligjit për energjinë elektrike dhe votojmë tani.
Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.

Kemi sugjerime të deputetëve dhe të komisioneve.

Sipas të gjitha diskutimeve, me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, pika 4 e amendamentit duhet të votohet. Kështu ishin diskutimet.

Atëherë, votojmë rekomandimet e deputetëve që ishin dhe të Komisionit për Legjislacion, pika 4 të hyjë në fuqi.

Amendamenti 35, hynë me vërejtjet e Komisionit për Legjislacion.

(Ndërhyrje)

E, nëse nuk e kemi të qartë, atëherë mund ta lëmë ligjin për tjetër ditë dhe ta shqyrtojmë edhe një herë, se unë nuk jam komisioni. Pra, nëse duhet, edhe një herë Komisioni për Legjislacion mund ta shqyrtojë. E kemi pikën 4, hiqet dispozita “deri në 3 vjet” dhe mbetet dispozita “sipas dispozitave të Kodit penal”. Kjo është. A jeni dakord për këtë?

Atëherë, e votojmë amendamentin 35 sipas vërejtjeve të dhëna dhe votojmë tani:
Miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 37.

Në sallë janë 70 deputetë! Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi Ligjin për energjinë elektrike. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Rregullativin e Energjisë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ose raportuesin që të marrë fjalën. Kush e dëshiron fjalën? Ethem Çeku e keni fjalën.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, zoti kryesues!

Kam diçka edhe rreth Rregullatorit. Ligji mbi Rregullatorin është nga ligjet që është punuar në komision mjaft gjatë. Kemi pasur opinione, debate se si mund ta funksionalizojmë sa më mirë Zyrën e Rregullatorit. Në një periudhë të caktuar Zyra e Rregullatorit ka pasur ndikime shumë të mëdha dhe ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në fushën e energjisë elektrike, Edhe tani është kërkuar që me amendamentimet që janë bërë të ketë një funksion sa më të fuqishëm, edhe pse, të themi, kohën e fundit Zyra e Rregullatorit në disa raste opinioni i Zyrës së Rregullatorit është anashkaluar. Në këtë

drejtim ne kemi dhënë dhe diku janë nja 44 amendemente. Kemi pasur disa qasje sa i përket pozitës së Zyrës së Rregullatorit në procesin e tenderimit, a duhet të jetë apo s’duhet të jetë, në përgjithësi mendoj se është një ligj i mirë për Zyrën e Rregullatorit. Kemi pasur edhe ndërhyrje të Komisionit Evropian, Sekretariatit për Energji, siç ka qenë edhe në dy ligjet paraprake që është kërkuar të respektohen shumë zhvillime të reja në sektorin e energjisë elektrike. Unë ftoj deputetët që ta aprovojnë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A e keni kërkuar fjalën, a? Deputetja Ahmetaj e ka fjalën.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të kërkoja mirëkuptim nga ju dhe nga të gjithë deputetët për një shkarje pak nga rendi i ditës. Sot Parlamenti Evropian, në mbledhjen të cilën e ka mbajtur në lidhje me liberalizimin e vizave për Shqipërinë dhe për Bosnjën, ka votuar pro liberalizmit të vizave për qytetarët shtetas të Shqipërisë dhe shtetasit e Bosnjës me 538 vota “për”, 47 vota “kundër” dhe do të dëshiroja nga Kuvendi që në një formë ta përgëzojmë dhe urojmë Qeverinë shqiptare dhe boshnjake për këtë arritje, me dëshirën që shumë shpejt edhe Kosova t’i bashkëngjitet një procesi dhe një arritje të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që është e arritur dhe është mirë që ta përshëndesim të gjithë këtë të arritur. Megjithatë, ne po vazhdojmë me shqyrtimin e pikave në fjalë të rendit të ditës. Për projektligjin në fjalë, diskutues tjerë nuk janë paraqitur për të propozuar diçka. Janë gjithsej 44 amendemente nga komisioni funksional. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 28.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.

Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 35.

Ju lus, të nderuar deputetë, e keni të ndaluar të flisni ju që jeni në lozhë, ose dilni jashtë! Dilni jashtë, të gjithë që jeni në lozhë. Jashtë! Nuk keni të drejtë të flisni me deputetë!

Amendamenti 36.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 36.

Është hera e fundit që, ju që jeni në lozhë, të keni të drejtë dhe të flisni me deputetë! Ose, as deputetët s'kanë të drejtë të flasin atje. Ju lutem, ata janë për të dëgjuar, për të marrë shënime, por jo për të bërë pazare. OK. Në rregull, në rregull! Deputetët kanë të drejtë për t'i thyer rregullat. Jo, jo, s'ka konsultant! Jashtë, në zyra, jo këtu në sallë. Jo, jo, Gani, të lutem! Veç në zyra dhe jashtë, këtu jo. OK. Unë s'kam çka të bëj! Në parlamentet tjera jo të flitet, por asnjëri me tjetrin ata s'guxojnë të flasin, po këtu është bërë pazar dhe OK.

Amendamenti 37.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44, i fundit.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 44.

Tani votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 73 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatoj se me 68 vota “për”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Kalojmë në pikën e dhjetë:

10. Projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet e Financa, zotin Gani Koci apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandimet. Ftoj zotin Koci ta marrë fjalën!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet e Financa, në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, me qëllim të shqyrtimit dhe propozimit të ndryshimeve të Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, ka krijuar një grup të punës – një nën-komision, të cilin nën-komision e ka kryesuar anëtarja e komisionit Myrvete Pantina.

Grupi punues ka mbajtur shumë takime, në të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me ekspertët e GTZ-së dhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, bashkërisht kanë harmonizuar qëndrimet rreth ndryshimeve dhe amendamentimit të këtij projektligji që është propozuar dhe që e kemi sot para vetes.

Duhet të them se me miratimin e këtij projektligji plotësohen zbrazësitë juridike dhe krijohet një bazë më e fortë ligjore në përmirësimin e procedurave të administrimit të tatimit në pronën e paluajtshme dhe përmirësimin e shërbimeve për tatim-paguesit që kjo fushë deri më tani ka qenë e rregulluar me rregullore të UNMIK-ut.

Me këtë projektligj përcaktohet baza dhe shkalla e tatimit, qartësohen procedurat e ankesave dhe të institucioneve që merren me to. Është bërë përmirësimi i shërbimeve për tatimpaguesit, ku kërkohet shpërndarja dy herë në vit e formularëve ose e faturave tatimore në bazë të kësteve të pagesave dhe këtu ka një veçori se deri më tani këta formularë ose këto fatura janë shpërndarë nga Ministria e

Ekonomisë e Financave dhe këtu ka një, ta quaj, dekoncentrim ose një decentralizim të pushtetit ose të shërbimeve që kjo tani me këtë projektligj iu është lënë komunave në dispozicion dhe këtë për hir të ofrimit të shërbimeve më të sakta dhe më të afërta për tatimpaguesit.

Projektligji përmban edhe Deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian për koordinimin, zhvillimin dhe integrimin evropian të datës 5.3.2010, në të cilën thuhet se tatimi në pronën e paluajtshme nuk është rregulluar në nivel të BE-së, respektivisht nuk ka ndonjë akt normativ që rregullon çështjen në fjalë dhe si e tillë do të thotë është në përputhje dhe është në vullnetin e legjislacionit vendor dhe nuk ka kundërshtim me ligjet e Bashkimit Evropian.

Duhet të them se rreth amendamenteve ku edhe kanë ndodhur ndryshimet më të mëdha, amendamenti 5, që korrespondon me nenin 7, shtohet një paragraf i ri 2.7, i cili ka të bëjë me pronën e papërfunduar si një formë e pronës dhe e cila duhet të tatimohet, prona në ndërtim e sipër nuk i plotëson kushtet për shfrytëzim ose për përdorim normal dhe që do të tatimohet jo në shkallën e plotë të tatimit, por mbi shkallën e asaj se sa është e përdorueshme dhe ne kemi shkuar deri në 40% të këtij lloji të pronës, pastaj ndryshime janë bërë në nenin 13, në nenin 14 që janë ndryshime pak më esenciale dhe që kanë definuar disa çështje të cilat nuk janë në projektligj dhe nuk kanë qenë as në rregulloren e UNMIK-ut. Për më gjerë, rreth ndryshimeve eventuale që kanë ndodhur, Myrvete Pantina është e gatshme, sigurisht ka çka të thotë, si kryesuese e komisionit të grupit punues...

KRYESUESI: Unë mendoj që i kemi amendamentet, ju të komisionit s'ka nevojë të dytë të flisni, besoj. Megjithatë, si deputete e ka të drejtën. A, Gani? Zoti Koci, e ka fjalën!

GANI KOCI: Është një çështje teknike që duhet të përmirësohet nga shërbimi i përkthimit, sepse teksti në gjuhën shqipe nuk korrespondon me përkthimin që është në gjuhën serbo-kroate. Prandaj, duhet të përmirësohet dhe të harmonizohet teksti i gjuhës serbo-kroate me tekstin në gjuhën shqipe. Këtë e keni para veti dhe e shihni se nuk është i përputhshëm, prandaj këtu shërbimi do të duhej që të veprojë dhe të punojë në këtë drejtim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Vetëm një plotësim. Ndryshimi i tekstit apo dallimi në përkthim ekziston në nenin 13 dhe nenin 15, të cilat përndryshe vërtet janë amendamenti 13 dhe amendamenti 15, si amendamente të deputetes Kosora Nikoliq. Këto amendamente janë miratuar, janë pranuar nga komisioni funksional, mirëpo janë lëshuar gabime teknike me rastin e përkthimit, prandaj duhet të bëhet ky harmonizim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se ndonjëherë do të kemi lektorë të mirë, dhe OK. Le ta marrë parasysh pastaj administrata këtë punë.

Në këtë projektligj janë propozuar 17 amendamente nga komisioni funksional dhe 2 amendamente nga deputetja Kosara Nikoliq, të cilat janë përkrahur nga komisioni funksional. Po fillojmë me votimin e amendamenteve veç e veç.

Në sallë janë 62 deputetë.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13, i deputetes Kosara Nikoliq, me përkrahje të komisionit funksional.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15, i deputetes Kosara Nikoliq, me përkrahje të komisionit funksional.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19, i fundit.

Votojmë tani:

Miratohet amendamenti 19.

Tani votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Ju njoftoj se në sallë janë 65 deputetë. Ftoj edhe të tjerët që janë jashtë që të kenë durim edhe për dy ligje që janë në radhë, t'i miratojmë.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati ta votojmë ligjin në tërësi dhe votojmë tani:

Konstatoj se me 65 vota “për”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet e Financa, zotin Gani Koci, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni e ka kryer punën e vet në amendamentimin e këtij projektligji, me të njëjtin grup të punës dhe me të njëjtit anëtarë të Komisionit.

E veçanta e këtij projektligji është sepse në të kanë ndihmuar shumë akterë dhe shumë institucione nga Banka Qendrore, pastaj Banka Gjermane për Zhvillim, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe shumë subjekte tjera që kanë qenë të interesuara rreth miratimit dhe nxjerrjes së këtij ligji. Ka qenë kërkesë e Komisionit për Buxhet e Financa edhe në leximin e parë të këtij projektligji se ky projektligj na është drejtuar në Kuvend para se të na vijjnë ligjet tjera, siç është Ligji për bankat, sepse tash kemi të bëjmë me sigurimin e depozitave. Megjithatë, na është dashur për shkak se në plotësimin e këtij fondi që duhet të krijohet për sigurimin e depozitave, Banka Gjermane ka kontribuar me 5 milionë euro dhe kemi pasur një afat të caktuar deri kur duhet ta miratojmë këtë ligj, në mënyrë që t'i thithim ato mjete dhe të krijojmë bazën e sigurimit të këtyre depozitave. Fondi parashihet që t'i ketë nga 15 milionë për vitin e parë, por në këta 15 milionë, 5 milionë i kemi donacione nga të tjerët, prandaj e kemi ndryshuar atë rendin e gjërave, sepse Ligji i bankave është dashur të na vijë këtu përpara, por si i tillë plotëson këtë fushë dhe ka qenë edhe kërkesë e akterëve tjerë dhe mendoj që Kuvendi duhet t'i miratojë këto amendamente. Është diçka për herë të parë që po aplikohet te ne në Kosovë, për deri sa vendet tjera këtë çështje e kanë të rregulluar. Ka pasur shumë pyetje se sa është ajo shkalla e sigurimit dhe a është në përputhje me zhvillimin e tregut financiar në Kosovë dhe ne kemi shkuar sipas kutit tonë, sepse s'kemi mund të krahasohemi me vendet tjera. Dhe, dikujt mund t'i duket pak ndoshta ajo shkallë e sigurimit, por me kohë sigurisht ky fond do të rritet dhe do të përmirësojmë e ndryshojmë edhe këtë shkallë të sigurimit të depozitave.

Ju ftoj që t'i votoni amendamentet.

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tani

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.
Votojmë tani:
Miratohet amendamenti 25, i fundit.

Tani votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.
Në sallë janë 71 deputetë. Votojmë tani.
Faleminderit!

Me 64 vota “për”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara, me përjashtim të Komisionit për Komunitete dhe Kthim, i cili nuk ka paraqitur raport me shkrim.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, zotin Esat Brajshori apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë Raportin me rekomandime.

Zoti Brajshori, e ka fjalën!

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë, edhe një herë!

Projektligji për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, në parim është miratuar në Kuvendin e Kosovës, në seancën plenare, më 6 shtator 2010, domethënë, këtu e një muaj më parë.

Komisioni e ka përgatitur raportin, me rekomandime, më 4 tetor 2010 dhe i ka shqyrtuar amendamentet e deputetëve: Enis Kervan, Mufera Shinik dhe Mahir Yagcillar dhe nuk e ka përkrahur me arsyetimin se ky amendament është i përfshirë në amendamentet e Komisionit.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 6 tetor 2010, gjithashtu ka shqyrtuar edhe raportet e komisioneve kryesore.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, ka pasur vërejtje në nenin 14.1.5. të cilën vërejtje komisioni funksional e ka përkrahur.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 10.

Dhe, siç thatë edhe ju, Komisioni për Komunitete dhe Kthim nuk e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit funksional, me arsyetimin se duhet kohë shtesë për të shqyrtuar çdo amendament nga aspekti i të drejtave dhe interesave të komuniteteve në procesin e regjistrimit.

Tani ju e dini se sa është i rëndësishëm miratimi i këtij projektligji për faktin se ky Kuvend ka miratuar një datë se kur duhet të bëhet regjistrimi i popullsisë, i ekonomive familjare dhe banesave në vendin tonë dhe miratimi i këtij projektligji ka të bëjë edhe me nevojën e alokimit të donatorëve që do ta ndihmojnë këtë proces, pra, regjistrimin e popullsisë.

Unë nuk do të isha lëshuar më shumë në detaje, rëndësinë e tij e dinë të gjithë deputetët. Faleminderit për fjalën dhe ju bëj thirrje që të votohet projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur, s' ka. Në këtë projektligj janë propozuar 20 amendamente nga komisioni funksional dhe 1 amendament nga deputetët: Enis Kervan, Mufera Shinik dhe Mahir Yagcillar, që nuk është përkrahur nga komisioni funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raport.

Amendamenti 1.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Votojmë tani.
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10 i ka dy propozime:
I pari, është i Komisionit funksional dhe
I dyti, është i deputetëve: Enis Kervan, Mufera Shinik dhe Mahir Yagcillar, pa përkrahje të komisionit funksional.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dëshiroj të jap pak sqarime lidhur me amendamentin numër 10, për propozimin e amendamentit të deputetëve nga Partia Turke. Në Komisionin e Komuniteteve dhe Kthimit kemi diskutuar këtë çështje dhe kemi qenë të mendimit se duhet të riformulohet ky amendament, prandaj me të njëjtin mendim është diskutuar çështja edhe e Komisionit e Legjislacionit. Pra, unë nuk jam anëtar i Komisionit të Legjislacionit, por kam qenë prezent në atë takim dhe unë sa i kam shënimet e mia, ka qenë që t'i adresohet komisionit funksional, nga Komisioni i Legjislacionit, propozim, ku thuhet që pas fjalisë, do të thotë në nenin 14.1.5, llojet e pyetësorëve, në fund, të shtohet fjalia “në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe në komuna me gjuhë në përdorim zyrtar”. Prandaj, sot jemi mbledhur prapë në Komisionin për Komunitete dhe Kthim dhe amendamenti i komisionit funksional ka qenë pak ndryshe dhe unë vetë personalisht kam shkuar te administrata e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe kam kërkuar transkriptet apo procesverbalet, por më kanë thënë se pas një jave mund t'i kemi. Prandaj, ka qenë një diskutim tjetër në komision, kanë rënë dakord, sa e kuptova unë atë ditë në komision, të gjithë anëtarët e Komisionit që të jetë : “në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe në komuna me gjuhë në përdorim nëpër këto komuna”, por fatkeqësisht në amendament tash nuk ekziston kështu, te komisioni funksional.

Kisha pasur dëshirë të jap pak sqarime lidhur me këtë çështje, sidomos prej atyre deputetëve – kolegë të cilët na kanë mbështetur në këtë drejtim në Komisionin e Legjislacionit dhe të Gjyqësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Mendoj se mjafton kryetari i Komisionit, të tjerët s'ka nevojë.
Zoti Bahri Hyseni e ka fjalën, si kryetar i komisionit funksional.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është e vërtetë që në takim ka qenë prezent deputeti i nderuar që sa po diskutoi dhe prezentë kanë qenë edhe përfaqësuesit e Ambasadës.

Komisioni për Legjislacion nuk ka pasur asnjë dilemë rreth amendamentit që e kanë propozuar komisionet tjera, por ka qenë dilema që Komisioni funksional ka sjell një amendament ku ka kërkuar që të fshihet: “në gjuhët zyrtare në Kosovë” dhe ka rekomanduar që të jetë në përputhje me Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare që është në fuqi në Kosovë.

Komisioni për Legjislacion e ka modifikuar amendamentin dhe unë nuk e di çka është problem transkripti, janë prezentë të gjithë anëtarët, asnjë presje nuk e kemi ndryshuar prej asaj që jemi marrë vesh dhe po e lexoj raportin, vetëm te kjo pjesa ku kemi intervenuar dhe kjo është zyrtare. Se si e kanë kuptuar në komision, nuk e kuptoj, por kjo është ajo zyrtare dhe ne kemi thënë këtë, zoti Enis:

“Komisioni sugjeron që formulimi i nenit 14.1, paragrafi 5, të mbetet si në projektligj”. Se paraprakisht ju thashë, që komisioni funksional e ka fshirë “gjuhët zyrtare në Kosovë”. Të mbetet, domethënë, si në projektligj, që nënkupton, në fund të paragrafit të theksuar, pas fjalës “Kosovë”, “gjuhët zyrtare në Kosovë” të shtohen fjalët “dhe sipas gjuhëve që kanë statusin e gjuhëve zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve”. Bile, ne e kemi shkruar edhe numrin e ligjit, për të mos u shqetësuar, dhe komisioni funksional e ka bërë të njëjtën, prandaj nuk po di çfarë shqetësimi është dhe nuk po e di ku e kemi bërë atë lëshim.

Unë besoj se të gjithë anëtarët e Komisionit njëzëri jemi pajtuar për këtë. Ne nuk kemi autoritet të dalim mbi ligjet të cilat i kemi aprovuar në këtë Kuvend dhe nuk kemi autoritet për t'i interpretuar as paragrafët e ligjeve tjera. I vetmi autoritet që është në komision, jemi thirrur në Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Nëse e ka kuptuar dikush përdorimin e gjuhëve, ne e kemi pasur fjalën për Ligjin dhe ai quhet vetë Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligji për gjuhët, për përdorimin e gjuhëve dhe ndoshta këtu ka qenë ai keqkuptimi për shkak që ndoshta s'e kanë kuptuar gjuhën. Mirëpo, megjithatë, ne nuk mund të bëjmë me këtë ligj gjuhë zyrtare tjera. Ato i ka bërë Kushtetuta dhe Ligji ekzistues. Kjo është krejt në rregull. Unë mendoj se e kam dhënë sqarimin.

KRYESUESI: Mirë, unë mendova se nuk do të hapim debat. Tani janë të paraqitur disa. Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi. Unë nuk e di pse ka nevojë të bëjmë sqarime shtesë, kur janë dy amendamente dhe i votojmë ato.

Zoti Kosumi, e keni fjalën!

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Unë mendoj se nuk u sqarua gati kurrëgjë, do të thotë, jemi si qysh u tha në fillim, nuk është e sqaruar, prandaj e mora fjalën, përndryshe nuk do ta merrja fjalën.

Idea që kur është diskutuar ky propozim në Komisionin për Legjislacion ka qenë kjo:

“Formularët për regjistrimin e popullsisë duhet të shkruhen edhe në gjuhët që janë në përdorim zyrtar për komunat ku jetojnë pjesëtarët e atij komuniteti që e përdorin atë gjuhë”.

Është shumë e qartë kërkesa e deputetëve që e kanë bërë. Komisioni funksional nuk e ka miratuar, do të thotë, një kërkesë të tillë, por në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi është përkrahur kërkesa, por e riformuluar. Përmendësh nuk e di, por do të thotë ideja është kjo:” Formulari për regjistrimin e popullsisë”, ta zëmë në Prizren, do të jetë edhe në gjuhën turke.

Unë po shoh se ka reagime, por unë po tregoj se ideja ka qenë kjo. Në gjuhët që janë në përdorim zyrtar.

KRYESUESI: Ne nuk mund të flasim për idenë në kundërshtim me ligjin. Tani, unë nuk po e di pse?

BAJRAM KOSUMI: Nuk është në kundërshtim me ligjin, kryesues! Nuk është në kundërshtim me ligjin!

KRYESUESI: Ne e kemi Ligjin për përdorimin e gjuhëve. E kemi Kushtetutën dhe nuk di pse po duhet ta diskutojmë këtë.

BAJRAM KOSUMI: Dhe, çështja e dytë, meqenëse e mora fjalën, ne po e miratojmë këtë ligj pa raportin e Komisionit për Komunitete dhe Kthim. Keni parasysh, mos jemi duke bërë punë të kotë. Ju si kryesues, duhet ta keni parasysh mos është kjo punë e kotë. Pa Raportin e Komisionit për Komunitete dhe Kthim po e miratojmë ligjin, do të thotë, është pak problem në aspektin procedural kjo çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryesues, është mirë që ne e kemi ministren prezent dhe mund ta elaborojë tamam këtë nen, sepse këtu flitet për punën, dizajnimin dhe shtypjen e pyetësorëve.

Asnjë fjalë nuk do ta ndryshoja atë çka e tha kolegu Bajram Kosumi për atë çka kemi biseduar ne në Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi. Është nënkuptuar që të mos shkelet Kushtetuta, mos të shkelet Ligji për gjuhët zyrtare, por i kemi dhënë përparësi regjistrimit të popullsisë, duke marrë parasysh se ky regjistrim nuk ka ndodhur që 30 vjet, prandaj, të kemi kujdes dhe ta diskutojmë në mënyrën më të mirë.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi, mirë e shpjegoi në mënyrën zyrtare se si do të jetë dhe si interpretohet ligji? Por, këtu duhet të shikohet mundësia, a mund ta fusim ne në përdorim zyrtar nëpër komuna ashtu siç kërkojnë 3 deputetët nga komuniteti turk?

KRYESUESI: Unë nuk e kisha hapur debatin lidhur me këtë çështje. Të gjithë e dinë se çfarë thotë ligji dhe i kemi dy amendamente. Unë propozoj që t'i tërhiqni diskutimet, t'ia japim fjalën ministres, si fjalë përfundimtare, dhe t'i votojmë dy amendamentet, në qoftë se kemi mirëkuptim. Në qoftë se jo, unë sipas Rregullores jam i detyruar t'ua jap fjalën të gjithëve. Unë nuk di çfarë kemi, përveç se t'i përsërisim të njëjtat gjëra. Nuk e di, çka kemi të flasim. Do të thotë, nuk doni t'i tërhiqni diskutimet. Sigurisht, zonja deputete dhe faleminderit që po ma përkujton! Zoti, Ramosaj, a dëshironi fjalën? Jo.

Zoti Makolli, e keni fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ideja që e kemi pasur në Komision për Legjislacion e Gjyqësi ka qenë që secili qytetar të informohet në gjuhën e vet, sepse kjo është e drejtë kushtetuese që secili qytetar, madje edhe ai i privuar nga liria e ka të drejtën e informimit në gjuhën e vet. Formulari është edhe një mjet i informimit, përpos që shërben për t'i marrë shënimet, është edhe mjet i informimit, prandaj do të duhej të respektohej kjo e drejtë kushtetuese.

(Ndërhyrje)

E kam marrë vesh koleg, unë ndoshta jam më pak patriot se sa ti, po... Jo, po ti po di çka po flet!

Zoti kryesues, po ju lus që të mos lejoni interferime të tilla të njerëzve të papërgjegjshëm në këtë Kuvend, absolutisht, të njerëzve të papërgjegjshëm, sepse nuk është hera e parë që ka ndërhyrje të tilla. Unë jam për atë që të respektohet e drejta e secilit qytetar në këtë vend për t'u informuar në gjuhën e vet, sepse është e drejtë kushtetuese. Dhe këtë të drejtë nuk ka të drejtë askush t'ua marrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kushtetuta dhe ligji ua ka dhënë dhe decidivisht është e shkruar se cilat janë gjuhët zyrtare dhe ku mund të përdoret gjuha e pakicave tjera, prandaj edhe në cilat rrethana. Deputeti Gani Koci dëshiron prapë ta marrë fjalën.

GANI KOCI: Zoti kryesues,

Singerisht, veç po e përsërisim vetveten dhe njëri-tjetrin në këtë rast. Neni 5 i Kushtetutës e thotë qartë dhe në qoftë se ne në amendamentin e propozuar themi sipas Kushtetutës dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, nënkupton edhe informimin e qytetarëve në gjuhën të cilën e flasin. Nëse shkojmë në ligj, e të themi të përdoret kjo gjuhë e ajo gjuhë, Kushtetuta e përcakton qartë se ku, cila gjuhë mund të përdoret, Ligji në të vërtetë e përcakton se ku, kur kalohet kufiri i caktuar i popullsisë dhe në përdorim zyrtar e dimë se cilat gjuhë i kemi dhe përdorim zyrtar të gjuhëve të pakicave ligj përcakton ku dhe aty nuk guxojmë të bëjmë ne asnjë shkelje.

Amendamenti i propozuar, po them i rirregulluar nga Komisioni për ligjet plotëson komplet amendamentin e propozuar nga 3 deputetët e Partisë Turke këtu në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Esat Brajshori e ka fjalën. Unë, s'mundem në kundërshtim të vullnetit të tyre të punoj.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, kryesues! Unë mendoj se veç po riciklohet debati, nuk po themi asgjë të re, sepse e thotë Ligji për përdorimin e gjuhëve. Nëse ne i referohemi asaj çka thotë Ligji për përdorimin e gjuhëve, nuk kemi se pse ta stërzgjatim me propozime dhe amendamente tjera. Nuk jemi askush kundër të drejtave të minoriteteve, përkundrazi, por atë që e thotë ligji, nuk kemi nevojë ta bisedojmë disa herë.

Unë jam që të hidhet në votim dhe të shkojmë me votim të kësaj çështjeje. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Gani Geci e ka fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, kryesues!

Ligji për përdorimin e gjuhëve e rregullon mirë edhe këtë çështjen që po e kërkojnë deputetët në fjalë.

Një prej pikave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve është ashtu që nëse në atë komunë, të cilën 5% e përbëjnë minoritetet, e kanë si gjuhë zyrtare për përdorim, por edhe pika 5.2 ose 4.2 thotë që si gjuhë e veçantë ose gjuhë me traditë është edhe gjuha që është nën atë nëse është me gjuhë me traditë. Ata e kanë një vendim nga Kuvendi komunal i Prishtinës dhe nga Kuvendi komunal i Vushtrrisë dhe Kuvendi komunal i Mitrovicës dhe në bazë të Ligjit të përdorimit të gjuhëve mund të shtypin fletëvotime në bazë të asaj dhe ato fletëvotime të shpërndahen, faktikisht jo fletëvotime për fletëregjistrime që ato të shpërndahen në komunitetet e tyre dhe të bëhet regjistrimi në gjuhët e tyre. Do të thotë, nuk mund... ne edhe i jemi referuar atij ligji. Do të thotë, meqë i jemi referuar atij ligji, në atë ligj janë edhe paragrafët që e rregullojnë edhe këtë çështje dhe ne kemi biseduar edhe më herët me deputetët, por edhe me zëvendësambasadorin ose kush është ky dhe është e rregulluar me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe i është referuar Ligjit për përdorimin e gjuhëve edhe aty ku është traditë dhe nëse ne i referohemi një paragrafi në ligj aty pason edhe një paragraf tjetër që e rregullon edhe çështjen tjetër. Do të thotë, unë nuk shoh ndonjë problem që me Ligjin e përdorimit të gjuhëve të ketë ndonjë problem këtu në bazë edhe të asaj çka po kërkojnë deputetët e minoritetit, por edhe Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që e ka thënë. Faktikisht ne kemi dashur që t'ua lejojmë, por e lejon edhe ligji. Do të thotë, meqë e lejon edhe ligji, sepse ligji ka dy paragrafë, atëherë unë nuk shoh ndonjë problem në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESEUSI: Faleminderit! Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ligji për përdorimin e gjuhëve rregullon se cilat janë gjuhët zyrtare dhe cilat janë gjuhët në përdorim nëpër komunat ku jetojnë mbi 5% të popullatës. Dje pas dite kam marrë ftesën përmes telefonit nga administrata e Kuvendit që propozim-amendamenti i përfaqësuesve të komunitetit turk ka hasur në mirëkuptim në Komisionin funksional dhe në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi jam ftuar që sot në orën 9,30 ta organizoj takimin e Komisionit dhe nga Komisioni të miratohet ky projekt... amendament.

Kur kemi ardhur në Komision nuk ka qenë ashtu siç kanë kërkuar komunitetet, prandaj edhe sot kemi ardhur pa raport në këtë drejtim. Por në fund duhet të them se edhe amendamenti i Komisionit funksional, edhe amendamentet e propozuara nga deputetët e komunitetit turk janë të përfshirë në amendamentin 10. Asgjë s'e konteston këtë, por për t'ua mbaruar qejfin mund të thuhet: "edhe gjuhët zyrtare që përdoren nëpër komuna" që s'e rendon asgjë. Prandaj, amendamenti 10 i plotëson të gjitha kriteret i komisionit funksional, por edhe nuk e rëndon as ligjin, as Kushtetutën në qoftë se thuhet: "edhe gjuhët në përdorim në komuna", formularët shtypen, sepse ka të bëjë me regjistrimin civil. Kjo ishte çka desha të them, përndryshe, pa fajin tim dhe pa fajin e anëtarëve të komisionit sot jemi pa raport.

KRYESUESI: Ne të paktën duhet të dimë se as si ide, as si qëndrim që është në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën nuk mund të ecim, pa marrë parasysh vullnetin e mirë. Ne propagandë mund të bëjmë, ka për t'u bërë edhe propaganda për regjistrimin në televizione, edhe me fletushka, në të gjitha gjuhët, nëpër komunat përkatëse, ama ligji nuk është propagandë. Ligji është ligj dhe në qoftë se ne miratojmë diçka në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën, unë s'po e marr vesh pse po e mbrojmë... Do të thotë, ne kemi dëshirë, por është në kundërshtim me ligjin.

Deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Jo, mendoj që u kuptuam shumë drejt, mirëpo mos të dalë dikush qëllimisht këtu tash që gjëja diçka tjetër kemi biseduar dhe diçka tjetër po miratojmë. Ne kemi diskutuar në parim

dhe i kemi rekomanduar komisionit funksional që qytetarët kanë të drejtë për t'u informuar dhe të shërbehen në gjuhën e vet dhe t'ua japim të drejtën, dhe këtë të drejtë e kanë pikërisht nga amendamenti i komisionit funksional. Unë nuk po di si e lexojnë, por nëse e lexojnë mirë, thotë: “dhe sipas gjuhëve që kanë statusin e gjuhëve zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve”. Mos të dalë dikush që po i mbron komunitetet më shumë e dikush më pak. Pikërisht për komunitete se s'ka pasur nevojë hiq ta bëjmë, mirëpo pikërisht duhet sqaruar, me qenë më të qartë për komunitetet e kemi bërë këtë dhe besoj se këtu nuk dimë çka të bëjmë tjetër veç ta përshkruajmë komplet edhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Nëse doni e përshkruajmë, por nuk është rregull juridike dhe nuk i shkon as Kuvendit, as kurrkujt.

KRYESUESI: I lus deputetët që të vijnë në sallë. Deputeti i fundit i paraqitur është Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues! E shpjegoi kolegu. Desha vetëm t'ua tërheq vëmendjen deputetëve turq që janë këtu. Ne e kemi bërë një lëshim dashamirës ndaj komunitetit turk, kur e kemi pranuar gjuhë zyrtare në komunën e Prizrenit, gjuhën turke, edhe pse nuk kemi pasur statistika të sakta a janë të komunitetit turk 5% në komunë të Prizrenit a nuk janë, se s'kemi pasur regjistrim. Një qytetar i komunitetit turk edhe në Prishtinë do ta marrë formularin në gjuhën e vet, do ta marrë formularin në gjuhën turke. Nuk ka problem, në çdo cep të Kosovës do ta marrë çdo qytetar në gjuhën e vet, edhe nuk ka nevojë këtu tash t'i komplikojmë gjëra. Komisioni e ka bërë një amendament, i cili nuk e diskriminon askënd, mirëpo një kontingjent i formularëve me siguri, përafërsisht 20.000 a 30.000 do të jetë, që çdo qytetar edhe i komunitetit boshnjak do ta marrë në çdo cep të Kosovës formularin në gjuhën e vet, kështu që është krejt e tepërt për të diskutuar sot këtu edhe për të kërkuar ndonjë të drejtë më shumë se që janë në ligj. Nuk e ka për qëllim askush që ta diskriminojë askënd në Kosovë, kështu që unë mendoj se duhet ta hedhim në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është ministrja Tahiri, për një sqarim shtesë që ka. E kërkuat me rregullore, me rregullore e keni!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional ka bërë një ndërhyrje me vend me amendamentin që e ka shtuar dhe e ka sqaruar që do të respektohet Ligji për përdorimin e gjuhëve. Pra, s'ka qenë kështu, atëherë e ka bërë intervenimin e drejtë. Me këtë rast, Ligji për përdorimin e gjuhëve, të cilin të gjithë ne këtu e kemi votuar, specifikon qartë që në nivel nacional janë dy gjuhë zyrtare: shqip e serbisht dhe në nivelet komunale, aty ku ka mbi 5% minoritete, respektohen gjuhët edhe të minoriteteve. Prandaj, edhe dokumentacioni do të jetë në frymën e kësaj.

Unë ju ftoj që ta votoni amendamentin e komisionit funksional dhe ndjehuni mirë të gjithë se veç jemi në rrugën e Kushtetutës edhe të ligjeve, dhe kjo kushtetutë, mund t'ju them edhe një herë, nuk ka në botë një shtet që i trajton më drejt komunitetet apo minoritetet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e hapim votim për amendamentin 10, por edhe dua t'ju sqaroj që ata që votojnë “për”, domethënë, votojnë për komisionin funksional, ata që votojnë “kundër”-votojnë për amendamentin e deputetëve: Enis Kervan, Mufera Shinik dhe Mahir Yagcillar. Këtë e thashë që të dimë për çka po votojmë. Faleminderit!

Votojmë tani.

Faleminderit! Konstatohet se amendamenti 10, i komisionit funksional miratohet me 55 vota “për”.

Për deputetët: Enis Kervan, Mufera Shinik dhe Mahir Yagcillar kanë votuar 3 deputetë dhe kanë abstenuar 4 deputetë.

Konstatohet se miratohet amendamenti 10, propozimin e komisionit funksional.

Vazhdojmë me amendamentin 11.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 19

Amendamenti 20.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 20.

Vazhdojmë me amendamentin 21.

Votojmë tani.

Miratohet amendamenti 21.

Fjalën e ka kërkuar, anëtar i Kryesisë, deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,
Deputetë të nderuar, kolegë,

Ne kaluam të gjitha amendamentet dhe unë e shoh të udhës që ky ligj të funksionojë dhe të jetë funksional pikë për pikë. Është mirë që të definohet kur zgjidhet Komisioni Qendror i Regjistrimit, që është organi themelor.

Në gjithë tërësinë e ligjit nuk ka ndonjë definim të vërtetë të kësaj, ndërsa çdo gjë i referohet këtij komisioni.

Unë kam diskutuar për këtë pikë edhe para një muaji, bile jam marrë strikt me këto data, po si duket njerëzit s'i kanë shikuar ato, nuk është me rëndësi.

Ajo që dua të them është se unë këtu duhet të propozoj një amendament, të cilin amendament paraprakisht e kam konsultuar me grupin tim parlamentar që më përkrah, të tjerët, të shohim.

Ky amendament do të kishte të bënte me nenin 12, pikën 2. Tash këtu shkruhet: "Komisionin Qendror të Regjistrimit e zgjedh Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë"- të shtohet: "6 muaj para datës së regjistrimit". Pse 6 muaj? Për shkak se komisionet zonale pastaj kushtëzohen me datë nga ky komision.

Ky është propozimi im. Unë ju lus të gjithëve që ta përkrahni, sepse është çelës...

(Ndërhyrje)

Unë propozova çka pata, ju lutem shumë, ky është propozim i amendamentit që e përkrah Lidhja Demokratike e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministrja Tahiri e ka fjalën.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Unë i kuptoj si qëllimmira këto propozime, mirëpo ne tash veç e kemi shkelur gjashtëmuajshin. Nëse e miratojmë këtë amendament, ne veç e kemi shkelur ligjin.

Unë kisha propozuar, të kundërtën, që menjëherë pas miratimit të këtij ligji le të zgjidhet komisioni menjëherë. Domethënë, ta ndërrojmë amendamentin, menjëherë duhet të zgjidhet. Përndryshe, nëse hyjmë në variantin që e keni propozuar, e kemi shkelur sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Unë propozova të jemi sistematik, bile një rregull ta ndërtojmë. Ministrja po do të më qes pak në dëshirore. Unë në dëshirore nuk bisedoj kurrë. Unë, a i shihni, të gjitha këto letra i marr para veti.

Ju e keni, zonja ministre, një nen atje, që edhe u votua, dhe unë nuk desha të merrem me atë punë, që e prodhon këtë gjashtëmuajshin. Prandaj, unë e lypj gjashtëmuajshin. Teksti është sistem dhe duhet të koordinohet prej germës së parë deri në të fundit.

Kjo që po them unë, nëse bëhet, kjo e ruan sistemin. Mirë, shtyhet pak kjo datë, por i shty edhe tjerat. Nëse kjo nuk vendoset këtu, të gjitha bien, se shtyhen gabimisht dhe bëhet një voluntarizëm

në interpretim. Prandaj, unë e thashë gjashtëmuajshin. Ju thoni 5 muaj, veç dine që keni brenda të votuar për komisionet zonale, që keni thënë gjashtë muaj.

Unë edhe një herë ju lus, votoni këtë përkufizim si e formulova unë – nenin 12.2. Kjo çel rrugë dhe e interpreton ligjin. Faleminderit!

(Ndërhyrje ministria Edita, nuk kuptohet për transkriptim)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues!

Zonja ministre, nëse nuk gabo, i ka 2 vjet më duket që ky Kuvend e ka zgjedhur komisionin, e di që tash ka një shtesë të numrave në këtë komision, që do të duhej të plotësohej, por nuk do të duhej që sa herë të ndërrohen ligjet, të ndërrohen komisionet, sepse ai e ka një mandat të dhënë nga ky Kuvend, sepse ndryshe logjikisht po i bie që edhe presidenti, pra është dashur të ndërrohet në momentin kur është miratuar Ligji për presidentin.

Komisioni është i zgjedhur nga Kuvendi, prandaj nuk shoh ndonjë arsye që do të duhej zgjedhur komision të ri me rastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KRYESUESI: Zoti Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Zoti kryesues, faleminderit shumë!

Ndoshta krejt në rregull e ka deputeti. Nuk po diskutojmë për përmbajtjen, por po bisedojmë për procedurën. Tash jemi në një fazë që nuk mund të bëjmë amendament. Po të ishte amendamenti këtu, do të kishim mundësi si deputetë për ta riformuluar, për ta ndryshuar, për ta hequr, mirëpo ne fare s'kemi amendament. Prandaj, nëse lëshohemi në amendamentet e tilla, do të kemi problem së pari se nuk ka kaluar në asnjë komision të përhershëm dhe komision funksional. Unë prita që po reagojnë zyrtarët që të ndihmojnë. Prandaj, është vetëm edhe çështje procedurale. Ne nuk kemi mundësi, edhe pse me rregullore, nëse e shihni këtë, thotë – grupi parlamentar ka të drejtë të propozojë amendamente, ka të drejtë, por me procedurë dhe sipas rregullave, mandej duhet të kalojë përmes komisioneve të përhershme. Si procedurë, unë konsideroj duhet të lëvizë.

KRYESUESI: Atëherë, ramë dakord, në qoftë se ka nevojë, më vonë kushdo ka të drejtë të kërkojë amendamente. Ramë dakord që konform Rregullores të procedojmë. Votojmë projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Nuk ka më diskutime. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.

Në sallë janë 73 deputetë.

Konstatoj që me 62 vota “për”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Faleminderit për durimin tuaj! Mirupafshim në seancën e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve